



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde



Sfidat në zbatimin e Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit



PRISHTINË, TETOR 2021

Autor: Leotrim Gashi

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Jeton Hasani

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Tetor, 2021
Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	5
Metodologjia	7
1. Historiku i Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit	8
1.1. Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit	9
2. Kërkesat e Viktimave të Krimit gjatë viteve 2019-Qershor 2021	9
2.1. Llojet e veprave penale për të cilat viktimat e krimit kanë bërë kërkesë për kompensim .	10
2.2. Vendimmarrja e Komisionit për kërkesat e viktimave të krimit.....	11
3. Zbatueshmëria e Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit: Analizë e 1,071 aktgjykimeve të shqiptuara nga 113 gjyqtarë të shkallës së parë në DKR dhe DP gjatë vitit 2020 dhe deri në qershor të vitit 2021	13
4. Zbatimi i LVKV-së sipas shtatë gjykatave themelore	17
4.1. Gjykata Themelore në Prishtinë.....	18
4.2. Gjykata Themelore në Prizren	19
4.3. Gjykata Themelore në Pejë.....	20
4.4. Gjykata Themelore në Ferizaj.....	22
4.5. Gjykata Themelore në Mitrovicë	23
4.6. Gjykata Themelore në Gjakovë	24
4.7. Gjykata Themelore në Gjiilan.....	25
5. Zbatimi pa bazë ligjore i LKVK-së në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë	27
6. Moszbatimi i LKVK-së nga Gjykata e Apelit	28
7. Gjykatat sigurojnë buxhet për Program, Qeveria nuk e mbush me buxhet, viktimat e krimit në pritje për kompensim	30
7.1. Nga pak kërkesa e shumë buxhet, në shumë kërkesa e pak buxhet.....	31
7.2. Të hyrat e realizuara nga prokuroritë e vendit për kompensimin e viktimave të krimit....	33
7.3. Taksat e gjykatave dhe të hyrat e KPK-së për viktimat e krimit nuk mbërrijnë në adresën e duhur	34
7.4. Ndikimi i IKD-së në rritjen e buxhetit të Programit	37
8. Institucionet publike nuk informojnë viktimat e krimit për ekzistimin e LKVK.....	39
9. Përfundimet	46
10. Rekomandimet	51

Lista e shkurtesave

KGJK– Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

ZKSH – Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

PSRK – Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

ZMNV – Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

MD – Ministria e Drejtësisë

MFPT – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

QPS – Qendrat për Punë Sociale

QKMF – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Komisioni – Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit

Programi – Programi për kompensimin e viktimave të krimit

IKD – Instituti i Kosovës për Drejtësi

DKR- Departamenti i Krimeve të Rënda

DP – Departamenti i Përgjithshëm

KPRK – Kodi Penal i Republikës së Kosovës

LKVK – Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit

1. Përmbledhje ekzekutive

Me miratimin e Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, i cili ka hyrë në fuqi më 15 korrik të vitit 2015, është menduar që Kosova ka arritur edhe një progres në fushën e legjislacionit të mbrojtjes së viktimave të krimit. Mirëpo, edhe pse nga ajo kohë kanë kaluar më shumë se gjashtë vite, praktika tregon që zbatimi i tij i plotë akoma nuk ka arritur qëllimin për të cilin është miratuar.

Funksionalizimi i Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit ishte arritur në maj të vitit 2017, ndërsa nga ajo kohë e deri në qershor të vitit 2021, janë bërë 120 kërkesa për kompensim. Gjatë periudhës kohore 2019 - qershor 2021, janë trajtuar 87 kërkesa për kompensim dhe Komisioni ka aprovuar 34 kërkesa apo 39%. Nga kërkesat e aprovuara, viktimat e krimit janë kompensuar me një shumë të përgjithshme prej 144,395.13 euro.

Me LKVK ishte paraparë që Programi mund të financohet në nga buxheti i Republikës së Kosovës, përmes kontributeve vullnetare dhe donacioneve private, si dhe nga taksat për kompensimin e viktimave të shqiptuara në aktgjykimet dënuese. Që nga funksionalizimi i Programit, Qeveria ka ndarë vetëm 187,000.00 euro (për vitet 2017 dhe 2018), ndërsa pas kësaj periudhe buxheti i Programit është siguruar vetëm nga të hyrat e KGJK dhe KPK. Edhe pse menjëherë pas funksionalizimit të Programit financimi nuk ishte parë si problem i punës së Komisionit, situata ka ndryshuar pas vitit 2019, pasi Programi nuk ka pasur të hyra të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha kërkesat e aprovuara të viktimave. MD, për

vitet 2019-2021, ka kërkuar nga Ministria e Financave që për Program të sigurojë një buxhet në vlerë prej 78,000.00 euro për secilin vit, apo 234,000.00 euro në total. Në vitin 2020, me aprovimin e 22 kërkesave të viktimave, ishte shpenzuar i gjithë buxheti i paraparë, gjë që kishte ndikuar që vendimet e aprovuara në fund të vitit 2020, në mungesë të buxhetit, të shtyhen për pagesë në vitin 2021. Buxheti prej 78,000.00 euro nuk do të jetë i mjaftueshëm as për viktimat të cilat paraqesin kërkesë për kompensim në pjesën e dytë të vitit 2021. Kjo ngase Komisioni deri më 30 qershor 2021 ka kompensuar nëntë (9) viktima, në shumën prej 33,200.00 euro apo 42%, të buxhetit, ndërsa kanë mbetur për tu shpenzuar vetëm edhe 44,800.00 euro për të cilat kanë bërë kërkesë edhe 10 viktima për të cilat nuk ka akoma një vendim për kompensim dhe përpos tyre edhe kërkesat e reja të viktimave që mund të bëhen gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2021.

Buxheti i Republikës së Kosovës për vitet 2018-2020 i ka ndarë Programit 243,000.00 euro, mirëpo në këtë periudhë raportuese vetëm nga KGJK dhe KPK në emër të kompensimit të viktimave të krimit janë siguruar 457,287.00 euro (385,851.00 nga KGJK dhe 71,436.00 nga KPK). MD nuk ka informacione se sa të hyra ka realizuar KGJK dhe KPK në emër të viktimave të krimit, ndërsa MFPT nuk është përgjigjur se si janë alokuar edhe 214,287 euro të siguruara nga KGJK dhe KPK, pasi të njëjtat edhe pse janë siguruar për tu transferuar në këtë Program, kjo gjë nuk ka ndodhur.

Nga hyrja në fuqi e LKVK në 2015 e deri në shtator të 2019, pra, në një periudhë mbi pesë vjeçare, gjyqtarët kishin detyruar të pandehurit e dënuar që, në emër të taksës, të paguajnë shumën në vlerë prej 195,141.00 euro. Ndërsa pas fillimit të hulumtimit të parë të IKD në këtë fushë, *“Dështimi i gjykatave në mbushjen e programit për kompensimin e viktimave të krimit”* (tetor 2019) për periudhën vijuese ka ndikuar që nga gjykatat të sigurohen fonde për Program në vlerë prej 299,630.00 euro, apo 104,489.00 euro më shumë se në periudhën paraprake.

Nga 1,071 aktgjykime dënuese të gjykatave themelore gjatë vitit 2020 (537) dhe janar-qershor 2021 (534), IKD ka gjetur se LKVK është zbatuar në 820 aktgjykime apo 76.56%, ndërsa nuk ka pasur zbatim të këtij Ligji në 251 aktgjykime apo 23.44%. Përderisa në raportin e parë të IKD, që ka përfshirë vitet 2018 dhe 2019, në DKR kishte pasur zbatim të LKVK vetëm në 40% të aktgjykimeve, gjatë vitit 2020 dhe deri në qershor të viti 2021, zbatimi i këtij Ligji në këtë departament ka pasur progres të theksuar, pasi është zbatuar në 90% të aktgjykimeve të analizuara. Mirëpo, situatë e ngjashme nuk është edhe për DP, pasi progresi i zbatimit në këtë departament është më i ulët. Nga 260 aktgjykime të analizuara në vitet 2018 dhe 2019, zbatim kishte pasur në 60% të tyre, ndërsa nga 738 aktgjykime të vitit 2021 dhe deri në qershor të vitit 2021, LKVK është zbatuar në 70.46% të aktgjykimeve.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, është e vetmja gjykatë e cila ka mundësi të bëjë vlerësimet e aktgjykimeve nga të gjitha gjykatat themelore të Kosovës dhe në këtë mënyrë të unifikojë praktikën e të gjitha

gjykatave themelore. Mirëpo, në raport me zbatimin e plotë të LKVK, nga dy hulumtimet e IKD-së, rezulton se këtë rol nuk është duke e përmbushur. Kjo ngase nuk është gjetur asnjë aktgjykim i Gjykatës së Apelit i cili ka zbatuar LKVK në rastet kur këtë nuk e kanë bërë gjykatat e shkallës së parë.

IKD ka analizuar edhe zbatimin e paragrafit 1 të nenit 28 të LKVK, që përcakton obligimin e institucioneve publike për të informuar lidhur me të drejtën e viktimave të krimit për kompensim nga shteti. Për këtë qëllim, IKD përmes monitoruesve ka vizituar 182 institucione publike në 35 komuna të Kosovës. Vetëm në pesë (5) objekte të institucioneve publike apo 2.73% , qytetarët mund të njoftohen për mundësinë e kompensimit si viktimë të krimit. Këto institucione të janë Gjykata Themelore në Gjakovë, Prokuroria Themelore në Prizren, Stacioni Policor në Ferizaj, Qendra për Punës Sociale e Komunës së Dragashit dhe Qendra për Punës Sociale e Komunës së Klinës. Në katër (4) nga këto institucione fletushkat informuese janë të përgatitura nga Ambasada Amerikane në Kosovë.

Në këtë Raport, IKD, për zbatim të plotë të LKVK, ka propozuar edhe rekomandime konkrete për të gjitha institucionet të cilat zbatojnë këtë Ligj.

2. Metodologjia

Me qëllim të përpilimit të një raporti sa më gjithëpërfshirës dhe analitik lidhur me zbatimin e LKVK, si në raportin e parë ashtu edhe në këtë raport, IKD ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit, në mënyrë që të paraqesë një pasqyrë të përgjithshme dhe reale mbi zbatimin e këtij Ligji. Për dallim nga raporti i kaluar, përveç analizimit të zbatimit të Ligjit nga ana e gjyqtarëve lidhur me shqiptimin e taksës për viktimat e krimit, në këtë Raport IKD ka hulumtuar edhe çështjen e informimit të viktimave të krimit nga ana e institucioneve publike, si kërkesë tjetër e këtij Ligji.

Për përgatitjen e këtij Raporti, IKD fillimisht ka analizuar bazën ligjore, përfshirë këtu edhe legjislacionin sekondar. Po ashtu, IKD, përmes Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, ka siguruar të dhëna relevante nga institucionet gjyqësore dhe qeveritare. Mbi të gjitha, përpilimi i këtij Raporti është bazuar në monitorimin e drejtpërdrejtë të zbatimit të LKVK nga ana e gjyqtarëve, në atë mënyrë që janë analizuar aktgjykimet e tyre dënuese, për të vlerësuar zbatimin e këtij Ligji. Monitorim i drejtpërdrejtë i është bërë edhe institucioneve tjera publike.

Në këtë drejtim, IKD ka analizuar gjithsej 1,160 aktgjykime dënuese, të përzgjedhura në mënyrë rastësore dhe proporcionale, për secilën gjykatë themelore (1,121) dhe Gjykatën e Apelit (38). IKD po ashtu ka siguruar edhe të dhëna statistikore nga KGJK si dhe nga Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të cilat janë shqyrtuar dhe analizuar në këtë Raport. IKD ka bërë monitorim të drejtpërdrejtë në 182 institucione nga 35 komuna të Kosovës, ku janë përfshirë gjykata, prokurori, stacione policore, QKMF, QPS, objekte komunale, strehimore, KGJK, KPK, ZKSH, ZMNV dhe MD.

3. Historiku i Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit

Deri në vitin 2015, Kosova nuk ka pasur bazë ligjore të duhur për kompensim të viktimave të krimit, duke mundësuar kështu shmangien e akterëve kompetentë nga përgjegjësia. Çështja e kompensimit të viktimave para miratimit dhe hyrjes në fuqi të LKVK, është rregulluar vetëm përgjithësisht dhe pamjaftueshëm përmes Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale dhe Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit.

Para miratimit të LKVK, viktimat e krimit mbështeteshin kryesisht në Kodin nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, sipas të cilit parashihej urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit si dënim plotësues. Ky urdhër ishte paraparë në nenin 62.1 të këtij Kodi, në të cilin përcaktohej se kur gjykata dënon personin i cili është shpallur fajtor për çfarëdo vepre penale që përfshin vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë, gjykata do të urdhërojë kryesin që të bëjë dëmshpërblimin e viktimës së veprës penale.¹ Megjithatë, kjo dispozitë rregullonte vetëm çështjen e kompensimit të viktimës direkt nga kryesi i veprës penale dhe asgjë më tepër.

Megjithatë, këto akte ligjore e rregullojnë vetëm përgjithësisht faktin se viktimave iu takon kompensimi, kurse përgjegjësinë për kompensimin e tyre ia lënë kryesit të veprës penale por pa specifikuar në detaje institucionet përgjegjëse dhe mënyrat apo

rregullimin e kompensimit në tërësi. Shembull, në rastin e Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, çështjet e kompensimit rregullohen vetëm sa i përket viktimave të trafikimit. Pra, në këtë mënyrë, kompensimi i viktimave të caktuara të krimit njihej në përgjithësi, por nuk rregullohej detajisht.

Me miratimin e Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Kosova ka shënuar një hap të rëndësishëm drejt rreshtimit krahas shteteve të cilat e trajtojnë dhe rregullojnë kompensimin e viktimave të krimit. LKVK ka listuar pesë kategori primare të veprave penale, viktimat e të cilave kanë të drejtë të përfitojnë nga ky Ligj. Këto vepra janë: vrasja, trafikimi me njerëz, dhunimi, keqpërdorimi seksual i fëmijëve dhe veprat e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Ligji këtyre i referohet si vepra të dhunshme dhe të cilat janë të kompensueshme. Ndërsa, përveç veprave primare, Ligji i ka dhënë mundësinë edhe viktimave të veprave të kategorive të tjera që të bëjnë kërkesa për kompensim, e në veçanti nëse viktima është viktimë e ndjeshme dhe më pas Komisioni do ta vlerësoi arsyeshmerinë e kërkesës lidhur me natyrën e dhunshme të veprës.

¹ Kodi Nr. 04/L-082 Penal, neni 62, par. 1.

1.1. Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit

Sipas nenit 23 të LKVK, Komisioni emërohet nga Qeveria e Kosovës dhe është në përbërje nga (7) shtatë anëtarë. Këtë Komision e kryeson një gjyqtar nga Gjykata Supreme, i propozuar nga KGJK, ndërsa nga një (1) anëtar në këtë Komision e kanë edhe secili nga këto institucione: Prokurori i Shtetit, i propozuar nga KPK; Kuvendi i Republikës së Kosovës, i propozuar nga Komisioni për Legjislacion; Ministria e Drejtësisë, i propozuar nga Ministri i Drejtësisë; dhe nga një përfaqësues nga shoqëria civile, i propozuar nga organizatat e shoqërisë civile. Ndërsa me propozim të Odës së Mjekëve, në këtë Komision bëjnë pjesë edhe dy (2) ekspertë mjekësorë të fushës së traumatologjisë dhe psikiatrisë.

Përpos kryetarit të Komisionit, i cili ka një mandat katër (4) vjeçar, anëtarët e tjerë kanë një mandat tre (3) vjeçar.² Sipas LKVK, Komisioni për ushtrimin e veprimtarisë së vet ndihmohet nga Ministria e Drejtësisë, e cila i ofron mbështetje administrative- teknike. Secila viktimë e cila synon të kërkojë kompensim nga Programi për Kompensimin e Viktimave, kërkesën duhet ta paraqesë në Ministrinë e Drejtësisë, ndërsa për plotësimin e kërkesës për kompensim mund të kërkojë ndihmën e mbrojtësit të viktimave apo organizatave joqeveritare që ofrojnë ndihmë juridike falas për viktima.³


4. Kërkesat e Viktimave të Krimit gjatë viteve 2019-Qershor 2021

Sipas të dhënave të MD, gjatë viteve 2019, 2020 dhe deri në qershor të vitit 2021, janë bërë 83 kërkesa për kompensim të viktimave të krimit, nga të cilat 16 në vitin 2019, 45 në vitin 2020 dhe 22 të tjera nga janari e deri më 30 qershor 2021.⁴

² Ligji Nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, neni 23.2.

³ Po aty, neni 29 dhe 30.

⁴ Përgjigja e Zyrës për Informim të Ministrisë së Drejtësisë, 08.10.2021.



Grafiku 1. Numri i kërkesave për kompensim nga viktimat e krimit gjatë viteve 2019, 2020 dhe 1 janar-30 qershor 2021

2.1. Llojet e veprave penale për të cilat viktimat e krimit kanë bërë kërkesë për kompensim

Sipas të dhënave të MD-së, Komisioni në vitet 2019-qershor 2021, ka trajtuar 87 kërkesa të viktimave (83 të pranuar në këtë periudhë raportuese dhe katër të bartura nga viti 2018) e shqyrtuara nga ana e Komisionit, numri më i madh i tyre janë bërë nga viktimat e veprave penale të vrasjeve dhe të dhunës në familje, ndërsa kërkesa në numër më të vogël janë bërë edhe për trafikim me qenie njerëzore, ngacmim seksual, keqtrajtim seksual i fëmijëve, lëndime të rënda trupore dhe vepra të tjera penale.

Nr	Vepra penale	2019	2020	Janar-Qershor 2021	Totali ⁵
1	Vrasje	5	18	8	31
2	Vepër tjetër	4	7	1	12
3	Dhunim	2	5	2	9
4	Dhunë në familje	4	8	6	18
5	Lëndime të rënda	1	3	3	7
6	Keqtrajtim seksual i fëmijëve	2	3	2	7
7	Ngacmim seksual	2	2	0	4
8	Trafikimi me qenie njerëzore	0	4	0	4
9	Lëndim i lehtë trupor	0	2	2	4
10	Grabitje	0	1	2	3
11	Vrasje e rëndë në tentativë	0	3	1	4
	Totali	20	56	27	

Tabela 1. Llojet e veprave penale për të cilat kanë bërë kërkesë për kompensim viktimat e krimit

2.2. Vendimmarrja e Komisionit për kërkesat e viktimave të krimit

Nga 87 kërkesat e trajtuara në periudhën raportuese janar 2019-qershor 2021, deri më tani janë aprovuar, 34 kërkesa apo 39.08%, janë refuzuar 43 të tjera apo 49.43%, ndërsa akoma nuk ka ndonjë vendim edhe për 10 raste të tjera apo 11.49%.

jatë vitit 2019, nga 20 kërkesat e trajtuara, katër nga të cilat ishin bartur nga viti 2018, Komisioni kishte aprovuar vetëm tri (3) kërkesa, gjashtë (6) i kishte refuzuar, kurse 11 të tjera i kishte bartur për vendimmarrje në vitin 2020.⁶ Pasi Komisioni nga prilli i vitit 2020 ishte në përbërje të plotë kishte arritur

që gjatë vitit 2020, nga 56 kërkesat që i kishte në punë të vendoste për 51 prej tyre, nga të cilat 29 i kishte refuzuar, ndërsa 22 të tjera i kishte aprovuar. Në këtë vit, pesë (5) kërkesa të palëve i kishte bartur për tu vendosur në vitin 2021. Po ashtu, nga 1 janari e deri më 20 qershor 2021, nga 27 kërkesat që Komisioni i ka pasur në punë, ka vendosur që t'i aprovojë nëntë (9) nga to dhe t'i refuzojë tetë (8) të tjera. Në fund të muajit qershor kanë mbetur në proces për t'u trajtuar edhe 10 kërkesa të tjera.

⁵ Shënim: Për shkak se nga të dhënat e MD-së, nuk arrihet të identifikohen se cilat kërkesa janë bartur nga viti në vit, nëse mbledhet totali i kërkesave sipas veprave penale për të gjithë periudhën raportuese, e prodhon numrin prej 103 kërkesave, por nga ky numër duhet zbritur 11 raste të cilat janë bartur nga viti 2019 në vitin 2020 dhe pesë (5) të tjera të cilat janë bartur nga viti 2020 në vitin 2021.

⁶ Shënim: Gjatë vitit 2019, Komisioni, për shkak të skadimit të mandatit të disa prej anëtarëve, kishte mbetur pa përbërje të plotë dhe për këtë arsye nuk ishin trajtuar shumë kërkesa. Kjo kishte vazhduar deri më 23 prill 2020, kur Qeveria kishte emëruar anëtarët e rinj të Komisionit. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/qeveria-ne-detyre-meron-anetaret-e-komisionit-per-kompensimin-e-viktimave-te-krimit/>). (Qasur për herë të fundit më 21.10.2021).

Kërkesat	2019	2020	Janar-Qershor 2021	Totali
Aprovuara	3	22	9	34
Refuzuara	6	29	8	43
Të bartura	11	5	0	
Në proces	0	0	10	10
Totali	20	56	27	87

Tabela 2. Kërkesat e viktimave të krimit dhe vendimmarrja e Komisionit përgjatë viteve 2019, 2020 dhe 1 janar-30 qershor 2021.

Gjatë kësaj periudhë raportuese, nga 34 kërkesat e aprovuara nga ana e Komisionit, viktimat e krimit janë kompensuar me një shumë të përgjithshme prej 144,395.13 euro.

Gjatë vitit 2019, vlera e kompensimit për viktimat e krimit ka qenë 19,260.00 euro, gjatë vitit 2020 91,935.13 euro, ndërsa nga janari e deri në qershor të këtij viti, 33,200.00 euro.

2019
• 19,260.00 €

2020
• 91,935.13 €

**Janar-Qershor
2021**
• 33,200.00 €

5. Zbatueshmëria e Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit: Analizë e 1,071 aktgjykimeve të shqiptuara nga 113 gjyqtarë të shkallës së parë në DKR dhe DP gjatë vitit 2020 dhe deri në qershor të vitit 2021

Për dallim nga raporti i kaluar kur si mostër ishin marrë nga pesë (5) aktgjykime për secilën departament të secilës gjykatë dhe degë të saj, për qëllime të këtij hulumtimi, me një mostër më të zgjeruar, IKD për vitin 2020 dhe për vitin 2021 ka analizuar 1,071 aktgjykime dënuese të DKR-së dhe DP,⁷ të cilat janë shqiptuar nga 113 gjyqtarë të gjykatave themelore në DKR dhe DP. Është synuar që për çdo gjyqtar të analizohen pesë (5) aktgjykime dënuese në vitin 2020 dhe pesë (5) të tjera për vitin 2021, por që kjo nuk është arritur të sigurohet në plotësi, për shkak se jo të gjithë gjyqtarët kanë pasur pesë (5) aktgjykime dënuese në vitin 2021, pasi disa kanë filluar punën në vitin 2021, disa të tjerë kanë pasur pozita menaxhuese në një periudhë të caktuar dhe disa të tjerë nuk kanë qenë transparentë me publikun pasi as nuk kanë publikuar aktgjykimet e tyre në web faqe të KGJK-së, e as nuk i kanë pajisur monitoruesit e IKD-së me aktgjykimet e kërkuara.


Nga këto aktgjykime, 537 janë të vitit 2020, ndërsa 534 të tjera janë të vitit 2021. Sa i përket departamenteve në të cilat janë marrë këto aktgjykime, 738 janë marrë nga 75 gjyqtarë të Departamentit të Përgjithshëm,

333 aktgjykime nga 38 gjyqtarë të Departamenteve të Krimeve të Rënda

Nga analizimi i 1,071 aktgjykimeve dënuese që janë marrë nga DKR (333) dhe DP (738), është parë se gjyqtarët kanë zbatuar LKVK-në në 820 aktgjykime apo 76.56%, ndërsa nuk ka pasur zbatim të këtij Ligji në 251 aktgjykime apo 23.44%. Nga këto 251 aktgjykime në të cilat nuk është zbatuar LKVK, në 53 nga to të dënuarit janë liruar nga të gjitha shpenzimet e bashkë me to edhe nga taksa për programin e viktimave dhe nëse hiqen këto 53 aktgjykime nga rastet kur nuk është zbatuar, rezulton se Ligji nuk është zbatuar në 198 aktgjykime apo 18.49%. Mirëpo, duhet theksuar se Kodi i Procedurës Penale ka paraparë që në rastet kur të pandehurit i rrezikohet gjendja e tij materiale të lirohet nga shpenzimet procedurale por sa i përket Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit dhe në këtë aspekt ekziston një zbrazëti, meqë nuk është përcaktuar nëse të pandehurit e liruar nga shpenzimet procedurale duhet të lirohen edhe nga taksa për kompensimin e viktimave të krimit dhe neni 39 i LKVK-së, nuk e ka trajtuar taksën për viktimat e krimit si shpenzim i procedurës por si formë e financimit të programit.

⁷ *Sqarim:* Aktgjykimet janë siguruar në mënyra ta ndryshme – disa janë marrë direkt nga web-faqja e gjykatave, për ato që s'kanë pasur asnjë/jo mjaftueshëm në numër aktgjykime të publikuara në webfaqe, aktgjykimet janë marrë

personalisht nga gjykatësit përmes monitoruesve përgjegjës, kurse disa të tjera përmes kërkesave për qasje në dokumente zyrtare.



Grafiku 2: Zbatimi i LKVK-së në vitin 2020 dhe janar-qershor 2021

3.1. Zbatimi i LKVK-së ndër vite në DKR dhe DP

Përkundër faktit se nga 15 korriku i vitit 2015, gjyqtarëve me ligj u është caktuar një obligim shtesë, ky obligim nuk është marrë me seriozitet nga sistemi i drejtësisë. Nga hulumtimi mbi zbatimin e LKVK gjatë viteve 2015-2017, IKD ka gjetur se ky Ligj pothuajse fare nuk është zbatuar gjatë asaj periudhe. Në këtë drejtim, IKD nuk ka arritur të sigurojë asnjë aktgjykim për vitet 2015-2017 ku personi i dënuar është detyruar që të paguajë taksën për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ashtu siç e kërkon LKVK. Kurse, bazuar në të dhënat lidhur me të hyrat e pranuar nga KGJK, si rrjedhojë e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, rezulton se për vitin

2015 KGJK nuk ka përpunuar fare këto të dhëna. Në vitin 2016 nuk janë grumbulluar të hyra, kurse në vitin 2017 në total janë grumbulluar vetëm 1,620 euro (510 euro nga Gjykata Themelore në Pejë, 1,080 nga ajo në Gjiilan dhe 30 euro nga ajo në Mitrovicë).⁸

Me qëllim të zbatimit të LKVK, Gjykata Supreme më 30 janar 2018 kishte nxjerr një qarkore e cila kishte për qëllim të zbatimit të ligjit nga ana e të gjithë gjyqtarëve.⁹ Ndërsa me qëllim të zbatimit sa më të plotë të këtij ligji, IKD në muajt gusht dhe shtator 2019, kishte zhvilluar 28 intervista, duke përfshirë kryesuesin e atëhershëm të KGJK-së, Skender Çoçaj, Kryetarin e Gjykatës

⁸ Gashi L. Reznici A. “Dështimi i gjykatave në mbushjen e programit për kompensimin e viktimave të krimit”. IKD. 2020. (Shih linkun <https://klics.org/wp-content/uploads/2020/06/Raporti-Deshtimi-i-gjykatave-ne-mbushjen-e-Programit-per->

[Kompensimin-e-Viktimave-te-Krimit-FINAL.pdf](#)). (Qasur për herë të fundit më 23.10.2021).

⁹ Qarkorja nr.35/2018 për Zbatimin e Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Prishtinë. 30 Janar 2018.

Supreme, atë të Apelit si dhe me të gjithë kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët mbikëqyrës të degëve të gjykatave themelore, të cilët kanë premtuar që do të marrin masa që ky ligj të ketë një zbatim uniform nga të gjithë gjyqtarët.

3.1.1. Zbatimi i LKVK ndër vite në DKR

Nga hulumtimi i parë që kishte realizuar IKD lidhur me zbatimin e LKVK, gjatë viteve 2015 dhe 2017 nuk ishte gjetur asnjë aktgjykim dënues, në të cilën gjykata kishte shqiptuar edhe taksën për kompensim të viktimave të krimit. Ndërsa, nga 35 aktgjykime të DKR-së (pesë aktgjykime për secilën gjykatë themelore), të shpallura gjatë vitit 2018, LKVK-ja ishte zbatuar në 17 aktgjykime, apo 48.57% të rasteve, ndërsa nuk ishte zbatuar në 18 aktgjykime apo 51.43% të rasteve. Zbatimi i Ligjit kishte shënuar progres në vitin 2019, ku nga 35 aktgjykime të DKR-së që ishin analizuar nga IKD-ja, Ligji ishte zbatuar në 25 raste, ndërsa nuk ishte zbatuar në 10.

Pas intervistave të zhvilluara me krerët e gjykatave dhe gjyqtarët mbikëqyrës, në bazë të monitorimit të IKD-së, është parë një trend pozitiv i zbatimit të LKVK-së dhe me qëllim të një analize sa më të detajuar, në këtë

Me gjithë faktin se gati të gjithë kryetarët e gjykatave mos zbatimin e LKVK e kishin konsideruar shkelje ligjore, deri më tani nuk ka asnjë inicim disiplinor për gjyqtarët të cilët nuk e kanë zbatuar LKVK-në.¹⁰


hulumtim janë analizuar nga pesë (5) aktgjykime për vitin 2020 dhe nga pesë (5) aktgjykime për vitin 2021, nga pothuajse të gjithë gjyqtarët që gjykojnë në këto departamente. Nga 333 aktgjykimet dënuese të shpallura nga DKR-të e shtatë (7) gjykatave themelore gjatë periudhës kohore janar 2020-qershor 2021, të analizura nga IKD, është gjetur se gjyqtarët kanë zbatuar LKVK-në në 300 aktgjykime apo 90.09%, ndërsa nuk kanë zbatuar atë në 33 aktgjykime apo 9.91%.¹¹

Ndërsa edhe nga analizimi i aktgjykimeve të ndara sipas viteve (2020 dhe 2021), shënohet një rezultat gati i ngjashëm, kjo pasi nga 169 aktgjykimet dënuese të viti 2020, Ligji është zbatuar në 151 raste, ndërsa nuk është zbatuar në 18 raste; kurse në vitin 2021, nga 164 aktgjykime të siguruara, Ligji është zbatuar në 149 aktgjykime, ndërsa nuk është zbatuar në 15 aktgjykime.

¹⁰ Përgjigja e KGJK-së përmes postës elektronike. 19.10.2021.

¹¹¹ Shënim: Nga 33 aktgjykimet e DKR-së në të cilat nuk është zbatuar ligji, në katër (4) prej tyre të

akuzuarit janë liruar nga të gjitha shpenzimet e procedurës.



Grafiku 3. Zbatimi i LKVK-së nga viti 2015 e deri në qershor 2021 nga DKR-të

3.1.2. Zbatimi i LKVK-së ndër vite në DP

Ashtu si në DKR, nga raporti i parë i kësaj çështje të realizuar nga IKD, as nga DP gjatë viteve 2016 dhe 2017 nuk ishte gjetur asnjë aktgjykim dënues, në të cilën kishte të shqiptuar edhe taksën për kompensim të viktimave të krimit. Nga 130 aktgjykime të DP-së (pesë aktgjykime për secilën gjykatë themelore dhe degët e tyre), të shpallura gjatë vitit 2018, LKVK ishte zbatuar në 68 aktgjykime, apo 52.31% të rasteve, ndërsa nuk ishte zbatuar në 62 aktgjykime apo 47.69% të rasteve.

Për dallim nga DKR-të, progresi i DP në zbatimin e LKVK-së rezulton se është më i ngadalshëm. Kjo për arsye se nga 130 aktgjykimet e analizuara në vitin 2019, Ligji ishte zbatuar në 88 aktgjykime apo 67.69%,


ndërsa nuk ishte zbatuar në 42 aktgjykime apo 32.31%. Ndërsa nga 738 aktgjykimet dënuese të shpallura nga DP-të e shtatë gjykatave themelore gjatë periudhës kohore janar 2020-qershor 2021, gjyqtarët kanë zbatuar LKVK-në në 520 aktgjykime apo 70.46%, ndërsa nuk kanë zbatuar atë në 218 aktgjykime apo 29.54%.¹²

Ndërsa edhe te ky departament, edhe nga analizimi i aktgjykimeve të ndara sipas viteve (2020 dhe 2021), rezulton se nga 368 aktgjykimet dënuese të vitit 2020, Ligji është zbatuar në 248 raste, ndërsa nuk është zbatuar në 120 raste,¹³ kurse në vitin 2021, nga 370 aktgjykime të siguruar, Ligji është zbatuar

¹²12 Shënim: Nga 218 aktgjykimet e DP-së, në të cilat nuk është zbatuar ligji, në 53 prej tyre të akuzuarit janë liruar nga të gjitha shpenzimet e procedurës.

¹³ Shënim: Nga 120 aktgjykimet e DP-së në vitin 2020, në të cilat nuk është zbatuar ligji, në 28 prej tyre të akuzuarit janë liruar nga të gjitha shpenzimet e procedurës.

në 272 aktgjykime, ndërsa nuk është zbatuar në 98 aktgjykime apo 26.49%.¹⁴



Grafiku 4. Zbatimi i LKVK-së nga viti 2015 e deri në qershor 2021 nga DP-të.

IKD konsideron se në këtë fazë sistemi gjyqësor ka progres në zbatim të LKVK-së, megjithatë që të sigurohet një zbatim i plotë i këtij ligji duhet që si KGJK ashtu edhe kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët

mbikëqyrës, të angazhohen sa më parë që të arrijnë kushtojnë vëmendje, zbatimin e e plotë të LKVK-së nga të gjithë gjyqtarët në nivel vendi.


6. Zbatimi i LVKV-së sipas shtatë gjykatave themelore

Përpos ndarjes sipas departamenteve, për të pasur ndarje më të detajuar se si shtatë (7) gjykatat themelore e zbatojnë LKVK-në, IKD edhe në këtë raport ka bërë analizën e aktgjykimeve të periudhës kohore janar-2020-shtator 2021, të ndara sipas gjykatave themelore, duke i rindarë ato sipas departamenteve dhe sipas degëve të tyre. Nga kjo analizë rezulton se Gjykata Themelore në Pejë, ajo në Ferizaj, Prizren dhe Gjakovë,

janë gjykatat të cilat kanë zbatuar më së shumti LKVK-në, ndërsa zbatim më i ulët të këtij Ligji është hasur në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Prishtinë dhe Gjiilan. Nga kjo analizë është parë se ka gjykata në të cilat ka një zbatim të plotë (100%) në DKR, ndërsa ka një zbatim më të ulët në DP, ku përfshihen edhe degët e këtyre gjykatave.

¹⁴ Shënim: Nga 98 aktgjykimet e DP-së në vitin 2021, në të cilat nuk është zbatuar ligji, në 25 prej tyre të

akuzuarit janë liruar nga të gjitha shpenzimet e procedurës.



Grafiku 5. Zbatimi i LKVK-së në vitin 2020 dhe janar-qershor 2021 nga DP-të.

4.1. Gjykata Themelore në Prishtinë

Në bazë të raporteve të punës për gjykata të KGJK-së, dëshmohej gati për çdo vit se Gjykata Themelore në Prishtinë së bashku me degët e saj në Podujevë, Drenas, Graçanicë dhe Lipjan, ka numrin më të madh të lëndëve në punë dhe në këtë kontekst edhe mundësia për shqiptimin e më shumë aktgjykimeve dënuese është më e madhe. IKD, për të verifikuar zbatimin e LKVK nga kjo Gjykatë, nga analizimi i 10 aktgjykimeve për vitet 2018 dhe 2019, në DKR kishte gjetur se në tetë (8) nga to nuk ishte zbatuar ky Kigj, ndërsa vetëm në dy (2) aktgjykime ishte zbatuar. Rezultat i ngjashëm ishte shënuar edhe me divizionin penal të DP-së në Prishtinë, kurse zbatim gati i plotë i Ligjit ishte parë në të dy vitet në degët e kësaj gjykate. Në përgjithësi, në bazë të 50 aktgjykimeve të analizuara në këtë Gjykatë


për periudhën 2018-2019, Ligji ishte zbatuar në 33 raste apo 66.00%, ndërsa nuk ishte zbatuar në 17 aktgjykime apo 34.00%. Lidhur me zbatimin e Ligjit, ish-nënkryetari i Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjyqtari Arben Hoti kishte thënë për IKD-në se “Çështja e zbatimit të kësaj takse sipas ligjit është obligative” dhe se sipas tij “Gjykata e Apelit me praktikën e saj mund ta etablojë një praktikë e cila do të jetë obligative në të ardhmen për gjyqtarët tanë.”¹⁵

Mirëpo, nga koha kur ishte zhvilluar intervista me gjyqtarin Hoti, zbatimi i LKVK nga kjo Gjykatë nuk ka arritur një progres të madh, me përjashtim se është parë një rritje e zbatimit të Ligjit nga gjyqtarët e DKR-së së kësaj gjykate. Nga 262 aktgjykime të analizuara në këtë Gjykatë për periudhën

¹⁵ Intervistë me Nënkyetarin e Gjykatës Themelore në Prishtinë z. Arben Hoti. 22.10.2019.

janar 2020-qershor 2021, Ligji është zbatuar në 172 raste apo 68.25%, ndërsa nuk është zbatuar në 90 raste¹⁶ apo 31.75%. Ndërsa nëse ndarja bëhet sipas departamenteve, shihet se nga 77 aktgjykime, DKR-ja ka zbatuar ligjin në 52 aktgjykime, apo 67.53%, ndërsa nuk është zbatuar në 25 aktgjykime.

Në përqindje pothuajse të njëjtë të zbatimit të ligjit është parë se ekziston edhe në DP. Në këtë departament, IKD ka analizuar 185 aktgjykime, ku në 120 ka pasur zbatim të ligjit, ndërsa në 65 aktgjykime apo 35.14%, nuk është zbatuar LKVK-ja.



Grafiku 6. Zbatimi i LKVK-së në vitin 2020 dhe janar-qershor 2021 nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

4.2. Gjykata Themelore në Prizren

Për dallim nga Gjykata Themelore në Prishtinë, në bazë të analizimit të 40 aktgjykimeve të Gjykatës Themelore në Prizren të shpallura në vitin 2018 dhe 2019, IKD kishte gjetur se kjo gjykatë kishte zbatimin më të lartë të LKVK. Në Gjykatën Themelore në Prizren dhe në degët e saj Suharekë dhe Dragash, nga 40 aktgjykimet e analizuara, ishte gjetur vetëm një (1) aktgjykim në DKR i cili nuk kishte zbatuar Ligjin, ndërsa ky Ligj ishte zbatuar në 39 aktgjykime të tjera. Në intervistën e tij për

IKD lidhur me zbatimin e Ligjit, ish-nënkryetari i kësaj gjykate, tani UD Kryetar, Artan Sejrani, kishte thënë se “Zbatimi i këtij Ligji fillimisht ka pasur pengesa në zbatim ngase gjyqtarët dhe stafi nuk kanë qenë në dijeni se si të ekzekutohet kjo shumë e ngarkuar për personat e shpallur fajtor, problemet kanë qenë teknike. Tani më ky ligj zbatohet nga të gjithë gjyqtarët e kësaj gjykate, në secilin rast penal personat e


¹⁶ Shënim: Nga 90 aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë, në të cilat nuk është zbatuar ligji, në tre

(3) prej tyre të akuzuarit janë liruar nga të gjitha shpenzimet e procedurës.

shpallur fajtorë ngarkohen edhe me këtë obligim siç e parasheh ligji.”¹⁷

Zbatim më i lartë se në gjykatat e tjera është parë edhe nga analizimi i 177 aktgjykimeve dënuese të kësaj gjykate, të cilat janë shpallur në periudhën janar 2020-qershor 2021. Nga këto aktgjykime, Ligji është zbatuar në 160 raste apo 90.40%, ndërsa nuk është zbatuar në 17 raste¹⁸ apo 9.60%, mirëpo në 14 nga këto aktgjykime, të akuzuarit janë liruar nga të gjitha shpenzimet e procedurës penale. Sa i përket zbatimit të Ligjit sipas departamenteve në këtë gjykatë, nga 47

aktgjykime të analizuara në DKR, ka pasur zbatim të plotë në të gjitha aktgjykimet (100%), ndërsa në DP, IKD ka analizuar 175 aktgjykime, në të cilat në 113 prej tyre është zbatuar LKVK-ja, kurse në 17 aktgjykime nuk është zbatuar ky Ligj, por që në 14 nga to, të akuzuarit ishin liruar nga të gjitha shpenzimet, që ndikon që nëse analizohen vetëm rastet kur të akuzuarit janë obliguar të paguajnë edhe shpenzimet e tjera, i bie që nga 163 aktgjykime të shpallura, ku të dënuarit janë obliguar të paguajnë shpenzimet e procedurës, vetëm në tri (3) prej tyre apo 1.84%, nuk është zbatuar LKVK-ja.



Grafiku 6. Zbatimi i LKVK-së në vitin 2020 dhe janar-qershor 2021 nga Gjykata Themelore në Prizren.

4.3. Gjykata Themelore në Pejë

Edhe në Gjykatën Themelore në Pejë dhe në degët e saj në Deçan, Istog dhe Klinë, ashtu si në analizën e aktgjykimeve të vitit 2018

dhe 2019, ku nga 50 aktgjykime të analizuara, ligji zbatohet në 90% të rasteve, ngase nga 50 aktgjykime të analizura, 35 prej

¹⁷ Përgjigjet për IKD-në e Nënkyetarit të Gjykatës Themelore në Prizren z. Artan Sejrani. 03.10.2019.


¹⁸ Shënim: Nga 17 aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Prizren, në të cilat nuk është zbatuar ligji, në 14 prej

tyre, të akuzuarit janë liruar nga të gjitha shpenzimet e procedurës.

tyre kishin zbatuar LKVK-në, edhe në analizën e 105 aktgjykimeve të vitit 2020 dhe 2021, në 86 nga to, është zbatuar ligji, ndërsa në 19 të tjera, të dënuarit nuk janë obliguar të paguajnë taksën e viktimave të krimit, mirëpo edhe në këtë gjykatë, në 16 nga 19 aktgjykimet ku nuk është zbatuar ligji, të dënuarit janë liruar nga të gjitha shpenzimet, që ndikon që nëse analizohen vetëm rastet kur të akuzuarit janë obliguar të paguajnë edhe shpenzimet e tjera, rezulton të jetë që nga 89 aktgjykime të shpallura, ku të dënuarit janë obliguar të paguajnë shpenzimet e procedurës, vetëm në tri (3) prej tyre apo 3.37%, nuk është zbatuar LKVK-ja.

Në DKR-në e kësaj gjykate, në 35 aktgjykime të analizuara, LKVK-ja është zbatuar në 30 aktgjykime, ndërsa nuk është zbatuar në pesë (5) të tjera¹⁹, ndërsa në DP, nga 70 aktgjykime dënuuese, ligji është zbatuar në 56 aktgjykime, kurse nuk është zbatuar në 14 të tjera.²⁰

Në intervistën e tij për IKD-në, lidhur me zbatimin e ligjit, ish-UD Kryetari i kësaj gjykate, Sami Sharraxhiu, kishte deklaruar se *“Gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Pejë e zbatojnë këtë dispozitë në të gjitha rastet kur i pandehuri shpallet fajtor. Moszbatimi i kësaj dispozite është shkelje.”*²¹



Grafiku 6. Zbatimi i LKVK-së në vitin 2020 dhe janar-qershor 2021 nga Gjykata Themelore në Pejë.

¹⁹ Shënim: Nga pesë (5) aktgjykimet e DKR-së, së Gjykatës Themelore në Pejë, në të cilat nuk është zbatuar ligji, në tri (3) prej tyre, të akuzuarit janë liruar nga të gjitha shpenzimet e procedurës.

²⁰ Shënim: Nga pesë 14 aktgjykimet e DP-së, së Gjykatës Themelore në Pejë, në të cilat nuk është

zbatuar ligji, në 13 prej tyre, të akuzuarit janë liruar nga të gjitha shpenzimet e procedurës.

²¹ Përgjigjet për IKD-në të Ushtruesit të Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë z. Sami Sharraxhiu. 02.10.2019.

4.4. Gjykata Themelore në Ferizaj

Në krahasim me raportin e kaluar të IKD-së lidhur me zbatimin e LKVK-së, rezulton se Gjykata Themelore në Ferizaj, që në kuadër të saj ka degën e Kaçanikut dhe Shtërpcës, ka arritur progresin më të madh në zbatimin e Ligjit. Nga 45 aktgjykimet e shpallura në vitet 2018 dhe 2019, IKD kishte gjetur se në 21 prej tyre apo 52.50% nuk ishte zbatuar Ligji, ndërsa në 19 aktgjykime apo 47.50%, ky ligj ishte zbatuar. Në atë kohë, edhe pse në DKR dhe divizionin penal të gjykatës, nga 20 aktgjykime, Ligji ishte zbatuar në 15 aktgjykime, në rritjen e numrit të moszbatimit të këtij Ligji kanë ndikuar degët e saj. Nga 10 aktgjykimet e degës së Kaçanikut, LKVK-ja ishte zbatuar në vetëm një (1) rast, ndërsa nga 10 aktgjykimet e degës së Shtërpcës, Ligji ishte zbatuar në vetëm tri (3) raste.

Mirëpo, përkundër kësaj, në intervistën e tij për IKD-në, ish-Kryetari i kësaj gjykate, gjyqtari Bashkim Hyseni, në tetor të vitit 2019 kishte thënë *“Zbatimi i ligjit ka filluar në vitin 2017, ndërsa aktualisht është duke u zbatuar nga të gjithë gjyqtarët, pasi mos zbatimi i tij paraqet shkelje ligjore.”*²²


Mirëpo për dallim nga ajo kohë, nga 138 aktgjykime dënuese, të periudhës kohore janar 2020-qershor 2021, që IKD ka analizuar, ka rezultuar se LKVK-ja është zbatuar në 121 prej tyre apo 87.68% të rasteve, kurse në 17 të tjera nuk është zbatuar. Edhe në këtë gjykatë, në 8 nga 17 aktgjykimet ku nuk është zbatuar Ligji, të dënuarit janë liruar nga të gjitha shpenzimet, që ndikon që nëse analizohen vetëm rastet kur të akuzuarit janë obliguar të paguajnë edhe shpenzimet e tjera, rezulton të jetë që nga 130 aktgjykime të shpallura, ku të dënuarit janë obliguar të paguajnë shpenzimet e procedurës, vetëm në nëntë (9) prej tyre apo 6.92%, nuk është zbatuar LKVK-ja.

Në DKR-në e kësaj gjykate, nga 40 aktgjykime të analizuara është parë se ka zbatim të plotë të ligjit, kurse në DP, nga 98 aktgjykime të analizuara, LKVK-ja është zbatuar në 81 aktgjykime, apo 82.65%, ndërsa nuk është zbatuar në 17 aktgjykime.²³

²² Intervistë me kryetarin e Gjykatës Themelore në Ferizaj. z. Bashkim Hyseni 03.10.2019.

²³ *Shënim:* Nga pesë 17 aktgjykimet e DP-së, së Gjykatës Themelore në Ferizaj, në të cilat nuk është

zbatuar ligji, në tetë (8) prej tyre, të akuzuarit janë liruar nga të gjitha shpenzimet e procedurës.



Grafiku 6. Zbatimi i LKVK-së në vitin 2020 dhe janar-qershor 2021 nga Gjykata Themelore në Ferizaj.

4.5. Gjykata Themelore në Mitrovicë

Edhe Gjykata Themelore në Mitrovicë, vit pas viti është duke shënuar progres në zbatimin e LKVK-së, mirëpo ka një dallim të madh në mes zbatimit të bërë në DKR me atë në DP, kjo ngase në DKR është gjetur se Ligji është duke u zbatuar në të gjitha rastet, ndërsa në DP ka zbatim më të ulët të Ligjit. Në raportin e kaluar, IKD kishte analizuar 60 aktgjykime të kësaj gjykate dhe degëve të saj në Vushtrri, Skenderaj, Zubin Potok dhe Leposaviq, që ishin shpallur në vitet 2018 dhe 2019, nga të cilat Ligji ishte zbatuar vetëm në 25 raste apo 41.67%, ndërsa nuk ishte zbatuar në 35 aktgjykime apo 58.33%.

Kryetari i kësaj Gjykate, Nikolla Kabashiq, në intervistën e tij për IKD-në lidhur me zbatimin e Ligjit, kishte thënë në mes të tjerave se “Ky ligj dhe ky format i përcaktuar


edhe me Qarkoren e Gjykatës Supreme, gjen zbatim të plotë pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë.”²⁴

Në periudhën janar 2020-qershor 2021, IKD ka analizuar 150 aktgjykime të kësaj Gjykate, ku nga këto aktgjykime, Ligji është zbatuar në 118 raste apo 78.67%, ndërsa nuk është zbatuar në 32 raste apo 21.33%. Mirëpo, në këtë Gjykatë është parë se Ligji është zbatuar në mënyrë uniforme në DKR, pasi kjo është parë nga analizimi i 60 aktgjykimeve të nxjerrja nga gjashtë (6) gjyqtar, ndërsa në DP, zbatimi i Ligjit është më i mangët, pasi nga 90 aktgjykime të këtij departamenti, ligji është zbatuar në 58 aktgjykime apo 64.44% të rasteve, kurse nuk është zbatuar në 32 aktgjykime të tjera apo 35.55%. Duhet theksuar se në DP, Ligji ka pasur mangësi të

²⁴ Përgjigjet për IKD-në e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë z. Nikolla Kabashiq. 04.10.2019.

zbatohet në degën kryesore të divizionit penal në DP, sepse në degët Vushtrri dhe

Skenderaj, Ligji është zbatuar në mënyrë të plotë.²⁵



Grafiku 6. Zbatimi i LKVK-së në vitin 2020 dhe janar-qershor 2021 nga Gjykata Themelore në Mitrovicë.

4.6. Gjykata Themelore në Gjakovë

Gjykata Themelore në Gjakovë me degët e saj në Malishevë e Rahovec, është një tjetër gjykatë e cila për dallim nga raporti i parë i IKD-së, është parë se nga ajo kohë, ka filluar ta ngrit nivelin e zbatimit të LKVK-së. Në raportin e kaluar, IKD kishte analizuar 40 aktgjykime të kësaj gjykate, që ishin shpallur në vitet 2018 dhe 2019, nga të cilat ligji ishte zbatuar vetëm në 18 prej tyre apo 45%, ndërsa nuk ishte zbatuar në 22 aktgjykime apo 55%. IKD, në periudhën janar 2020-qershor 2021, ka analizuar 80 aktgjykime të kësaj gjykate dhe ka gjetur se ligji është zbatuar në 64 raste apo 80%, që shënon një rritje shumë të madhe të zbatimit të ligjit, në krahasim me raportin e kaluar, ndërsa nuk

është zbatuar në 16 raste apo 20%. Në këtë gjykatë, vetëm në një (1) rast, i dënuari përpos që nuk është obliguar të paguajë taksën për kompensim të viktimave të krimit, është liruar edhe nga të gjitha shpenzimet e tjera të procedurës.


Në tetorin e vitit 2019, atëherë UD Kryetari i kësaj gjykate e tash Kryetari Nikollë Komani, në intervistën e tij për IKD-në, lidhur me zbatimin e ligjit kishte thënë “Qëndron fakti se fillimisht nuk është zbatuar ky ligj, mirëpo tani të gjithë gjyqtarët janë të njoftuar dhe kanë për djeni jo vetëm ekzistimin e këtij ligji por edhe me detyrimin për zbatimin e tij sa i për këtë kompensimit të viktimave të krimit në

²⁵ Shënim: IKD, nuk ka arritur të siguroj asnjë aktgjykim të degëve Leposaviq dhe Zubin Potok, për vitin 2020 dhe 2021.

lartësi siç është e përcaktuar me Ligjin numër 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimin”.²⁶

Nga analiza e 80 aktgjykimeve të shpallura në periudhën janar 2020-qershor 2021, në

këtë gjykatë është parë se ligji është zbatuar nga të gjithë gjyqtarët e DKR-së, pra në të gjitha 20 aktgjykimet, ndërsa nga 60 aktgjykimet e DP-së, ky ligj është zbatuar në 44 aktgjykime, kurse nuk është zbatuar në 16 aktgjykime.²⁷



Grafiku 6. Zbatimi i LKVK-së në vitin 2020 dhe janar-qershor 2021 nga Gjykata Themelore në Gjakovë.

4.7. Gjykata Themelore në Gjiilan

Gjykata Themelore në Gjiilan është gjykata tjetër ku progresi i zbatimit të plotë të LKVK është duke shkuar me hapa të ngadalshëm, kjo ngase përderisa nga analiza e 50 aktgjykimeve të viteve 2018, ligji ishte zbatuar në 24 prej tyre apo 48%, gati dy (2) vite më pas, nga analizimi i 159 aktgjykimeve është parë se ligji është zbatuar në 99 prej tyre apo 62.26%, ndërsa nuk është zbatuar në 60 të tjera apo 37.74%.²⁸ Mirëpo

rezultate pozitive nga koha kur ishte realizuar intervista e IKD-së me kryetarin e kësaj gjykate, Ramiz Azizi, vërehet se në DKR-në e kësaj gjykate ka zbatim shumë më të lartë të ligjit. Përderisa nga 10 aktgjykime të viteve 2018 dhe 2019, ishte gjetur se LKVK-ja ishte zbatuar në vetëm dy (2) prej tyre, ndërsa në të njëjtin departament nga 54 aktgjykime të analizuara, ky ligj është zbatuar në 51 aktgjykime, ndërsa në vetëm tri

²⁶ Përgjigjet për IKD-në e Ushtruesit të Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë z. Nikollë Komani. 04.10.2019.

²⁷ Shënim: Nga pesë 16 aktgjykimet e DP-së, së Gjykatës Themelore në Ferizaj, në të cilat nuk është


zbatuar ligji, në një (1) prej tyre, i akuzuari është liruar nga të gjitha shpenzimet e procedurës.

²⁸ Shënim: Nga 57 aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Prizren, në të cilat nuk është zbatuar ligji, në pesë (5) prej tyre, të akuzuarit janë liruar nga të gjitha shpenzimet e procedurës.

(3) të tjera nuk është zbatuar. Në njërin nga këto tri (3) aktgjykime, i dënuari është liruar nga të gjitha shpenzimet e procedurës penale.

Për dallim nga DKR-ja, DP-ja e Gjykatës Themelore në Gjiilan ka përqindjen më të lartë nga të gjitha departamenteve në moszbatimin e LKVK-së. Nga 105 aktgjykimet e analizuara në këtë divizion, të cilat janë shpallur në periudhën kohore janar 2020-qershor 2021, në shumicën prej tyre nuk është zbatuar LKVK-ja. Ky ligj është

zbatuar vetëm në 48 aktgjykime apo 46.85%, ndërsa nuk është zbatuar në 57 aktgjykime të tjera²⁹ apo 55.52%. Kryetari i kësaj gjykate Ramiz Azizi, në intervistën e tij për IKD-në, lidhur me zbatimin e ligjit, kishte thënë “Po, ligji në fjalë ka hy në fuqi ashtu siç edhe shkruan në kërkesën e Juaj, në vitin 2015. Pasi që është i obliguar, ai edhe parimisht aplikohet edhe në Gjykatën tonë. Pasi që është obligativ, ai edhe duhet të aplikohet detyrimisht.”³⁰



Grafiku 6. Zbatimi i LKVK-së në vitin 2020 dhe janar-qershor 2021 nga Gjykata Themelore në Gjiilan.

²⁹ Shënim: Nga 57 aktgjykimet e DP-së, së Gjykatës Themelore në Gjiilan, në të cilat nuk është zbatuar ligji, në vetëm katër (4) prej tyre, të akuzuarit janë liruar nga të gjitha shpenzimet e procedurës.

³⁰ Përgjigjet për IKD-në e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjiilan z. Ramiz Azizi. 14.10.2019.

7. Zbatimi pa bazë ligjore i LKVK-së në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë

Edhe pse IKD në vazhdimësi ka bërë thirrje që të ketë një zbatim të plotë të LKVK-së nga të gjithë gjyqtarët e të gjitha gjykatave, një thirrje e tillë, për shkak të mangësisë ligjore nuk mund të bëhet edhe për gjyqtarët e Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Ky Departament, së bashku edhe me Departamentin Special të Gjykatës së Apelit, ishte funksionalizuar për herë të parë me Ligjin nr.06/L-054 për Gjykatat, kishte hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2018, ndërsa Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ka hyrë në fuqi më 15 korrik 2015 dhe paragrafi 3 i nenit 39 të këtij ligji ka përcaktuar që taksa për viktimat e krimit të përcaktohet vetëm në aktgjykimet dënuese të Departamentit të Krimeve të Rënda dhe në ato të Departamentit të Përgjithshëm dhe nga ajo kohë nuk është miratuar në Kuvendin e Kosovës ndonjë ndryshim-plotësim i këtij ligji.³¹

Pasi që nga monitorimi i IKD-së është vërejtur se kjo taksë është duke u zbatuar edhe në këtë departament, nga 12 gjyqtarë aktualë të këtij Departamenti, kanë arritur të sigurojnë vetëm 26 aktgjykime të cilat janë shpallur në vitin 2020 dhe 2021, ngase shumica e gjyqtarëve të tjerë as nuk i kanë shpallur aktgjykimet e tyre në web-faqe të

gjykatës, as nuk ia kanë ofruar monitoruesve personalisht qasje e po ashtu as nuk është mundur që të sigurohen të njëjtat përmes kërkesave për qasje në dokumente publike. Nga këto 26 aktgjykime është gjetur se gjyqtarët pas asnjë bazë ligjore kanë detyruar të pandehurit e dënuar të paguajnë taksën për viktimat e krimit në 11 raste, kurse fatmirësisht nuk kanë zbatuar këtë ligj në 15 raste. Nga këto 15 raste, ku të akuzuarit nuk janë detyruar t'i paguajnë taksat për viktimat e krimit, në shtatë (7) prej tyre, të akuzuarit janë liruar nga të gjitha shpenzimet e procedurës penale.

Prandaj, me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, me gjithë rëndësinë që IKD-ja i kushton mbushjes së buxhetit të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, IKD konsideron se ky Departament nuk duhet që në asnjë aktgjykim të tyre të detyrojnë të dënuarit që t'i paguajnë taksat e përcaktuara me LKVK-në.

Po ashtu, nga analiza e pesë (5) gjyqtarëve të cilët në vitin 2020 kishin gjykuar në DKR-në e Prishtinës, nga 25 aktgjykimet e vitit 2020 në DKR, kanë zbatuar LKVK-në në vetëm gjashtë (6) aktgjykime, ndërsa nuk e kishin zbatuar këtë ligj në 19 aktgjykime.

Nga 26 aktgjykime dënuese të shpallura në periudhën janar 2020-qershor 2021 nga DS, është gjetur se gjyqtarët pas asnjë bazë ligjore kanë detyruar të pandehurit e dënuar të paguajnë taksën për viktimat e krimit në 11 raste, kurse nuk kanë zbatuar këtë ligj në 15 raste.

³¹ Shënim: Me propozim të IKD-së, në Projektligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të dënuarit nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore në

Prishtinë, në emër të taksës, do të obligohen të paguajnë shumën prej 100 eurove.

8. Moszbatimi i LKVK-së nga Gjykata e Apelit

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë është e vetmja gjykatë e cila ka mundësi që pas ankesave të prokurorisë, mbrojtjes apo të dëmtarëve, të bëjë vlerësimet e aktgjykimeve nga të gjitha gjykatat themelore të Kosovës dhe në këtë mënyrë ta unifikojë praktikën e të gjitha gjykatave themelore. Mirëpo në raport me zbatimin e plotë të LKVK-së, nga dy hulumtimet e IKD-së rezulton se Gjykata e Apelit, këtë rol që ia ka dhënë ligji nuk është duke e zbatuar. Kjo ngase nga IKD, nuk është gjetur asnjë aktgjykim i Gjykatës së Apelit i cili ka zbatuar LKVK-në në rastet kur këtë nuk e kanë bërë gjykatat e shkallës së parë.

Nga analiza e 40 aktgjykimeve, që gjykatësit e Gjykatës së Apelit i kishin marrë në vitet 2018 dhe 2019, IKD kishte gjetur se janë vërtetuar edhe aktgjykime në të cilat shkalla e parë nuk ka zbatuar LKVK-në. Nga 20 aktgjykime të DKR-së, në 13 raste ishin vërtetuar aktgjykimet në të cilat ishte zbatuar LKVK-ja, ndërsa në shtatë (7) aktgjykime, shkalla e dytë kishte vërtetuar aktgjykime të cilat nuk e kanë zbatuar LKVK-në ose edhe pse kishte ndryshuar aktgjykimet, pavarësisht se të akuzuarit ishin shpallur fajtor, nuk

kishin shqiptuar edhe taksën për kompensimin e viktimave të krimit.

Përpos IKD-së, mos zbatimin e LKVK-së e ka konsideruar si shkelje edhe ish-Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala. Në intervistën për IKD-në lidhur me këto gjetje, të realizuar në tetor të vitit 2019, Shala kishte thënë se gjyqtarët e gjykatës së Apelit në rastin kur të vendosin meritorisht për vendimet e shkallës së parë, në rastin kur kjo taksë nuk është caktuar, atëherë taksën do ta caktojnë vetë ata pasi mos zbatimi i LKVK – së konsiderohet shkelje. *“Ne jemi të obliguar me ligj që nëse nuk ka vendos lidhur me taksën gjykata e shkallës së parë, ne ta caktojmë, Gjykata e Apelit është ajo që e bën edhe unifikimin edhe të praktikës edhe të mendimeve juridike. Për këtë arsye unë mendoj që nuk ka nevojë lënda m’u prish nëse nuk u vendos, ne vendosim si Gjykatë e Apelit, e caktojmë këtë taksë”*.³² Gjyqtari Shala, përpos që mos zbatimin e ligjit nga ana e gjyqtarëve të Apelit e kishte konsideruar shkelje, ai në këtë intervistë po ashtu kishte thënë se do të merrte masa që LKVK-ja të zbatohet nga të gjithë gjyqtarët.

“Tash pas kësaj interviste që e bëmë unë do të takohem me kolegjin e gjyqtarëve të Departamentit të Përgjithshëm dhe Departamentit të Krimeve të Rënda, por edhe të Departamentit Special dhe do ta diskutojmë edhe këtë çështje edhe një herë në mënyrë që mos të na përvidhet ndonjë gabim”. Hasan Shala


³² Intervistë me Kryetarin e Gjykatës së Apelit z. Hasan Shala. 22.10.2019.

Mirëpo, pavarësisht këtyre gjetjeve dhe deklarimeve të ish-kryetarit të Apelit, moszbatimi i LKVK-së nga gjykatësit e DKR-së dhe DP-së, të Gjykatës së Apelit, është duke vazhduar. IKD në këtë hulumtim ka analizuar vetëm aktgjykimet e vitit 2020 dhe 2021, në të cilat janë vërtetuar aktgjykimet dënuese të shkallës së parë ose janë ndryshuar ato, por që përsëri të akuzuarit janë shpallur fajtor dhe në të cilat shkalla e parë nuk i ka obliguar të dënuarit, të paguajnë taksën për viktimat e krimit. Për qëllime të këtij hulumtimi, IKD ka siguruar 38 aktgjykime, nga të cilat është parë se në asnjë (0) rast, Apelit nuk i është dukur i rëndësishëm zbatimi i LKVK-së.

Nga 18 aktgjykime dënuese të shpallura nga DKR-të, ku gjykatat themelore nuk kishin zbatuar LKVK-në, gjyqtarët e Apelit gjatë vitit 2020 (10) dhe 2021 (8) në asnjë rast nuk kishin vendosur ta shqiptonin taksën për

viktimat e krimit. Nga këto 18 aktgjykime, Apeli i kishte vërtetuar 13 aktgjykime të shkallës së parë, që nuk kishin zbatuar LKVK-në, ndërsa edhe pse në pesë (5) aktgjykime ishte vendosur të ndryshoheshin aktgjykimet, në asnjë prej tyre, të dënuarit nuk janë obliguar të paguajnë taksën për viktimat e krimit.

Ngjashëm me DKR-të, edhe në DP-në e Gjykatës së Apelit, nga 20 aktgjykime të vitit 2020 dhe deri në qershor të vitit 2021, në asnjë rast gjyqtarët e këtij departamenti nuk kanë mënjeluar moszbatimin e LKVK-së që e kanë bërë gjyqtarët e gjykatave themelore. Në 16 aktgjykime janë vërtetuar aktgjykime në të cilat nuk e kanë zbatuar LKVK-në, kurse në katër rastet, me gjithë ndryshimet e aktgjykimeve, nuk është zbatuar taksë për kompensimin e viktimave në vlerë prej 30 eurove.



Grafiku 7. (Mos) Zbatimi i LKVK-së në vitin 2020 dhe janar-qershor 2021 nga Gjykata e Apelit

Ashtu siç kishte ndodhur me raportin e parë të IKD-së lidhur me moszbatimin e LKVK-së nga gjykatat, edhe në këtë hulumtim IKD ka gjetur se gjyqtarët e njëjtë të Gjykatës së Apelit, në një aktgjykim të marrë nga ta, kanë vërtetuar vendimin e shkallës së parë që ka zbatuar LKVK, ndërsa në raste të tjera, po të

9. Gjykatat sigurojnë buxhet për Program, Qeveria nuk e mbush me buxhet, viktimat e krimit në pritje për kompensim

Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit konsiderohet një nga ligjet më të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së viktimave të krimit, kjo ngase para hyrjes në fuqi të këtij ligji, viktimat e krimit, përpos statusit të tyre të rëndë me rastin e veprës penale, viktimizoheshin edhe më shumë pasi nuk kishin mundësi të kompensoheshin, ndërsa për të marrë një shpërblim të dëmit në procedurë civile, një qytetari i duhet të presë mesatarisht mbi katër (4) vite. Në bazë të raportit të IKD “Drejtësia civile në Kosovë, ligji VS praktika”, mesatarja e përfundimit të një lënde nga paraqitja e padisë e deri në një aktgjykim përfundimtar është 1,734 ditë apo katër vite e nëntë (9) muaj.³³ Në këtë raport po ashtu ishin gjetur raste kur një paditës ishte duke zhvilluar procedurë gjyqësore mbi 22 vite apo kur gjykata edhe pse në kundërshtim me Ligjin e Procedurës Kontestimore, kishte vendosur të thërriste

njëjtë kanë vërtetuar aktgjykimin i cili nuk ka zbatuar nenin 39 të këtij ligji, që tregon joseriozitetin e tyre në raport me detyrën e tyre për unifikimin e praktikës gjyqësore.

seancën e parë përgatitore, tetë (8) vite pas paraqitjes së padisë.

Para miratimit të LKVK dhe funksionalizimit të Programit për kompensimin e viktimave të krimit, përpos procedurave për shpërblimin e dëmit nga i pandehuri dhe kompensimin për viktimat e trafikimit, viktimat tjera mundësinë e vetme e kanë pasur ti drejtohen institucioneve të ndryshme si strehimoreve, Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave (ZMN), apo OJQ – të e ndryshme. Por, asnjëra prej këtyre institucioneve nuk ka pasur mundësinë e kompensimit të viktimave të krimit.³⁴ Duke parë këtë sistem të drejtësisë ku “gjykimi në një kohë të arsyeshme” është kusht vetëm në letër, padyshim se me LKVK është krijuar mundësia që në harmoni edhe me Direktivën 2004/80/EC e Këshillit të Evropës³⁵, viktimat së paku të kenë një satisfaksion nga shteti, por që nuk e ndalon atë të kërkojë dhe merr kompensim edhe nga i pandehuri, përmes procedurave gjyqësore. Me LKVK-në ishte

³³ Noca D. “Drejtësia civile në Kosovë, ligji VS praktika”. IKD. 2019. (Shih linkun <https://klics.org/wp-content/uploads/2019/11/IKD-Drejt%C3%ABsia-Civile-Ligji-vs.-Praktika-03.11.2019.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 24.10.2021).

³⁴ Gashi L. Rezniciq A. “Dështimi i gjykatave në mbushjen e programit për kompensimin e viktimave të krimit”. IKD. 2020. (Shih linkun <https://klics.org/wp-content/uploads/2020/06/Raporti-Deshtimi-i-gjykatave-ne-mbushjen-e-Programit-per-Kompensimin-e-Viktimave-te-Krimit-FINAL.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 23.10.2021).

[ks.org/wp-content/uploads/2020/06/Raporti-Deshtimi-i-gjykatave-ne-mbushjen-e-Programit-per-Kompensimin-e-Viktimave-te-Krimit-FINAL.pdf](https://klics.org/wp-content/uploads/2020/06/Raporti-Deshtimi-i-gjykatave-ne-mbushjen-e-Programit-per-Kompensimin-e-Viktimave-te-Krimit-FINAL.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 23.10.2021).

³⁵ Direktiva 2004/80/EC e Këshillit të Evropës për kompensimin e viktimave. 29.04.2004. (Shih linkun <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32004L0080&from=EN>). (Qasur për herë të fundit më 23.10.2021).

paraparë themelimi i Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, i cili është funksionalizuar më 11 maj 2017,³⁶ pra gati dy (2) vite pas hyrjes në fuqi të ligjit, ndërsa sipas LKVK-së, ky program mund të financohet në tri forma.³⁷

- a) Nga buxheti i Republikës së Kosovës për MD-në si pjesë e ligjit vjetor të buxhetit
- b) Përmes kontributeve vullnetare dhe donacioneve private
- c) Nga taksat për kompensimin e viktimave të shqiptuara në aktgjykimet dënuese.³⁸

LKVK ka paraparë që Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimit të financohet nga buxheti i shtetit. Kjo nënkupton se të hyrat që grumbullohen nga taksat për Programin e Kompensimit të Viktimave të Krimit, fillimisht shkojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës. Kjo procedurë është në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, përkatësisht nenin 2.3 ku përcaktohet se “*Të gjitha paratë publike*

duhet të depozitohen në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në pajtim me Rregullat e Kontrollit dhe Menaxhimit Financiar dhe paratë publike mund të shfrytëzohen ose shpenzohen vetëm pasi që të jenë ndarë në mënyrë të rregullt sipas këtij ligji”.³⁹ Të hyrat e këtyre mjeteve më pas i ndahen Ministrisë së Drejtësisë si pjesë e ligjit vjetor për buxhetin.

Sipas nenit 39.4, MD-ja gjatë procesit të rregullt buxhetor të përcaktuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, do të bëjë një kërkesë buxhetore për të financuar një linjë buxhetore për Programin e Kompensimit të Viktimave

të Krimit.” Në këtë drejtim, përkundër problemeve në zbatimin e LKVK-së, për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në vitin 2017, pas kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për Ministrinë e Financave, ishin ndarë gjithsej 100,000.00 euro. Kurse, një vit më vonë, më 2018, janë ndarë 87,000.00 euro.

7.1. Nga pak kërkesa e shumë buxhet, në shumë kërkesa e pak buxhet

Pas funksionalizimit të Programit, buxheti nuk ishte parë si problem i Komisionit për Kompensim të Viktimave të Krimit, por në atë kohë shqetësuese ishte që viktimat nuk

kishin informata për ekzistimin e këtij Komisioni dhe mundësinë që ata të kompensohen nga shteti. Nga funksionalizimi i Programit e deri më 31

³⁶ “Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimit” – broshurë informative. Qeveria e Republikës së Kosovës. 24

maj 2017. Prishtinë. 10 Ligji 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, neni 39, par. 1.

³⁷ Neni 39 i LKVK-së

³⁸ Shënim: Për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore

shuma prej tridhjetë (30) Euro, ndërsa për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Krimeve të Rënda i Gjykatës Themelore shuma prej pesëdhjetë (50) Euro.

³⁹ Ligji nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. neni 2.3

janar 2019, Kryesuesja e Komisionit, gjyqtarja Nesrin Lushta, kishte thënë se në këtë Komision ishin bërë 37 kërkesa, prej të cilave 20 ishin refuzuar dhe në një intervistë të saj për IKD-në, ajo kishte thënë se për shkak të numrit të ulët të kërkesave të viktimave, paratë nuk konsiderohen problem për viktimat e krimit. *“Pasi është numër i vogël i lëndëve që po na vjen, nuk po na ndikon vlerën e kompensimit. Kemi mjaftë të holla për me i kompensu edhe kemi punu në ndryshime në ligj që me i shut edhe disa vepra sepse kur është pru ligji nuk është ditë se qysh ka me qenë fondi për të holla pasi po shihet se nuk është problem”*.⁴⁰

Mirëpo edhe pse në vitet e kaluara për shkak të mos informimit të madh për qytetarët, viktimat e krimit nuk kanë parashtruar kërkesë për kompensim, pra ka pasur buxhet por nuk ka pasur kërkesa, IKD ka parë se aktualisht ekziston një ndryshim i kësaj situate, pra ka numër më të madh të kërkesave por Programi nuk ka buxhet të mjaftueshëm dhe viktimave i është dashur të presin me muaj që ta marrin kompensimin e aprovuar nga Komisioni.

Në bazë të përgjigjeve të MD-së, për vitet 2019, 2020 dhe 2021, kjo Ministri ka kërkuar nga Ministria e Financave, që për Program të siguroj një buxhet në vlerë prej 78 mijë euro për secilin vit apo 234 mijë euro në total.⁴¹ Por nga këto përgjigje po ashtu është kuptuar që përpos vitit 2019, kur në shumicën e vitit Komisioni ishte pa kuorum të anëtarëve, që kishte ndikuar të shpenzoheshin vetëm 19,260.00 euro nga i gjithë buxheti, në vitin

2020 dhe 2021, këto mjete janë të pamjaftueshme për të gjitha viktimat e krimit që bëjnë kërkesa për kompensim.

Në bazë të përgjigjes së MD-së, në vitin 2020, me aprovimin e 22 kërkesave të viktimave, ishte shpenzuar i gjithë buxheti i paraparë për kompensimin e viktimave të krimit. Për më tepër, gjatë këtij viti, edhe pse Komisioni ka pasur në dispozicion vetëm 78 mijë euro buxhet, ata kanë tejkaluar atë buxhet duke kompensuar viktimat në vlerë prej 91,953.13 euro, por që vendimet e aprovuara në fund të vitit 2020, në mungesë të buxhetit, ishin shtyrë për pagesë në vitin 2021.

Buxheti në vlerë prej 78 mijë euro duket se nuk do të jetë i mjaftueshëm as për viktimat të cilat bëjnë kërkesë për kompensim gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2021. Kjo ngase përpos kompensimit për viktimat për të cilët kërkesat ishin aprovuar në vitin 2020, Komisioni ka aprovuar edhe nëntë kërkesa të reja, për të cilat, deri më 30 qershor 2021 ka ndarë 33,200.00 euro apo 42.06%, ndërsa me këtë datë, akoma pa një vendim të Komisionit, kanë mbetur edhe 10 kërkesa. Dhe kur këtyre u shtohen edhe kërkesat e tjera që potencialisht mund të bëhen gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2021, mund të konkludohet se edhe në këtë vit mund të ketë raste kur viktimat për të cilat janë aprovuar kërkesat për kompensim do t'i duhet të presin deri në vitin tjetër që të kompensohen. Por kjo do të ishte në kundërshtim me qëllimin për të cilën është funksionalizuar Programi,

⁴⁰ Intervistë me kryetaren e Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nesrin Lushta, Prishtinë. 01 tetor 2019.

⁴¹ Përgjigja e MD-së për IKD-në. 08.10.2021.

që viktimat në procedura më të shpejta të kompensohen.

Se buxheti i ndarë për vitin 2021 nuk do të jetë i mjaftueshëm, është thënë në përgjigjen

e tyre edhe nga ana e MD-së: “*Sipas dinamikës së paraparë buxheti i ndarë për vitin 2021 nuk do të jetë i mjaftueshëm për të kompensuar të gjitha vendimet e aprovuara.*”⁴²

7.2. Të hyrat e realizuara nga prokuroritë e vendit për kompensimin e viktimave të krimit

IKD edhe në këtë vit, për qëllim të këtij hulumtimi ka trajtuar edhe çështjen e grumbullimit të mjeteve për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, nga ana e Prokurorisë. Ky obligim rrjedh nga neni 230 i KPPRK, ku është paraparë se me rastin e pezullimit të procedurës, i pandehuri, përveç të tjerave, duhet të paguajë shumën e caktuar për Programin për Kompensimin e Viktimave. Më saktësisht, KPPRK ka përcaktuar se Prokurori i Shtetit, me pëlqimin e të dëmtuarit, mund të pezullojë ndjekjen për veprë penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, duke pasur parasysh natyrën, rrethanat dhe karakterin e veprës penale dhe të kryerësit, nëse i pandehuri zotohet se do të sillet siç është udhëzuar nga prokurori i shtetit dhe se do t'i përmbushë detyrimet e caktuara që pakësojnë ose mënjanojnë pasojat e dëmshme të veprës penale, duke përfshirë edhe pagesën e një kontributi ndaj një institucioni publik ose

humanitar apo të fondeve për kompensimin e dëmit të viktimave të veprave penale.

Kryesuesi i KPK më 23 prill 2018 kishte nxjerrë Vendimin KPK/Nr.175/2018, për krijimin e llogarisë për inkasimin e të hyrave në emër të kompensimit të viktimave të krimit.⁴³ KPK kishte filluar të inkasojë të hyra në këtë llogari nga 7 qershori 2018 me UNIREF në emër të shërbimeve nga shitja. E që nga ajo kohë e deri më 31 dhjetor 2019, në emër të kompensimit të viktimave të krimit janë inkasuar në total 63,816.00€, mjete të cilat derdhen në buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Ndërsa në përgjigjen e KPK-së, të 5 tetorit 2020, ka rezultuar se KPK në emër të kompensimit të viktimave të krimit, ka inkasuar gjithsej 31,550.00 euro në vitin 2019, në vitin 2020 ka siguruar 7,620.00, ndërsa nga janari e deri në qershor 2021, janë inkasuar 9,850.00 euro.

Të hyrat e siguruara nga KPK	Të hyra
2018	€ 32,266.00
2019	€ 31,550.00
2020	€ 7,620.00
Janar-Shtator 2021	€ 9,850.00
Totali	€ 81,286.00

Tabela 3. Të hyrat e siguruara nga KPK për kompensimin e viktimave të krimit.

⁴² Po aty.

⁴³ Përgjigja elektronike e KPK për IKD, 15 maj 2020.

Lidhur me këto të hyra, IKD është informuar nga MD se ata nuk kanë bërë kërkesë në KPK për rimbursim të mjeteve të siguruara nga ana e taksave të shqiptuara, ndërsa lidhur me të

hyrat që ka siguruar KGJP në këtë periudhë, kanë thënë se përgjigjen duhet kërkuar në KPK.⁴⁴

7.3. Taksat e gjykatave dhe të hyrat e KPK-së për viktimat e krimit nuk mbërrijnë në adresën e duhur

Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit kishte hyrë në fuqi në korrik të vitit 2015, ndërsa edhe pse nga ajo kohë ky ligj është dashur të zbatohet, nga të gjeturat e IKD-së është parë se kjo gjë nuk ka ndodhur gjatë viteve 2015 dhe 2016, ndërsa në vitin 2017, në emër të Programit të Viktimave të Krimit nga gjykatat ishin siguruar vetëm 1,620 euro dhe atë vetëm nga tri (3) gjykata; 1,080 euro të grumbulluara nga ana e Gjykatës Themelore në Gjilan, 510 euro nga ajo në Pejë dhe vetëm 30 euro nga Gjykata Themelore në Mitrovicë.⁴⁵ Sipas të dhënave të KGJK-së, në vitin 2018 ka pasur avancim të mbledhjes së të hyrave për viktimat e krimit pasi gjykatat kishin arritur të grumbullojnë 81,851 euro.

Duke e ditur rëndësinë e Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, IKD-ja gjatë vitit 2019, nga monitorimi i saj gati në të gjitha gjykatat në Kosovë, ka kuptuar që në rast të zbatimit të LKVK-së nga të gjithë gjyqtarët, do të ndikonte që në mënyrë të drejtpërdrejtë të rritej buxheti i Programit dhe në këtë mënyrë do të kishte më shumë viktimat të cilat do të mund të kompensoheshin dhe që Komisioni, në

kuadër të minimumit dhe maksimumit të shumave të përcaktuara me LKVK, të kishte mundësi më të madhe të përcaktimit të shumave më të larta për viktimat e krimit. Për këtë arsye kishte zhvilluar intervista me të gjithë krerët e gjykatave dhe nga ajo kohë është parë një avancim i zbatimit të ligjit, që ka ndikuar në rritjen e të hyrave nga të pandehurit e dënuar.

Në këtë mënyrë, gjykatat në vitin 2019 kishin siguruar 158,470 euro,⁴⁶ ndërsa nga të dhënat e dërguara nga KGJK, rezulton se gjatë vitit 2020, pavarësisht situatës me pandeminë me Covid-19, ku për disa muaj nuk ka pasur zhvillim të proceseve gjyqësore, janë siguruar 145,530.00 euro, ndërsa nga fillimi i vitit e deri në qershor të vitit 2021, në KGJK kanë arritur 107,300.00 nga taksat për viktimat e krimit.⁴⁷

Mirëpo, pavarësisht se të hyrat nga taksat e shqiptuara nga gjykatat janë rritur dukshëm, të njëjtat nuk janë duke u dërguar në adresën e destinuar. Ky konkludim vjen në bazë të përgjigjeve që IKD ka marrë nga MD dhe KGJK, pasi gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020, vetëm nga taksat për viktimat e krimit

⁴⁴ Përgjigja e MD-së për IKD-në. 08.10.2021.

⁴⁵ Të dhënat e dërguara nga KGJK përmes postës elektronike. 04.11.2019.

⁴⁶ Të dhënat e dërguara nga KGJK përmes postës elektronike. 27.02.2020.

⁴⁷ Të dhënat e dërguara nga KGJK përmes postës elektronike. 19.10.2021.

janë grumbulluar 385,851.00 euro, ndërsa nëse këtyre ia shtojmë edhe të hyrat e siguruara nga KPK gjatë këtyre viteve, ku janë grumbulluar 71,436.00 euro, i bie që vetëm nga këto institucione janë siguruar 457,287.00 euro, kurse Programi për Kompensim, në këto vite ka pasur buxhet vetëm 243,000.00 euro.⁴⁸

Kjo ka ndikuar që viktimat e kompensuara të krimit në vitin 2020, të presin që t'i marrin të hyrat e tyre në vitin 2021 e në situatë të ngjashme mund të biejnë edhe viktimat e kompensuara në gjysmën e dytë të vitit 2021. IKD nga MD ka marrë përgjigje se ata nuk kanë bërë kërkesë në KGJK për rimbursim të mjeteve të siguruara nga ana e taksave të shqiptuara, ndërsa lidhur me të hyrat që ka siguruar KGJK në këtë periudhë, kanë thënë se përgjigjen duhet kërkuar në KGJK.⁴⁹


Për ta sqaruar këtë situatë, pra atë se ku janë alokuar edhe 214,287 euro, të siguruara nga KGJK dhe KPK me qëllim të kompensimit të viktimave të krimit, pasi të njëjtat edhe pse janë paguar për tu transferuar në këtë Program kjo gjë nuk ka ndodhur, IKD ka kërkuar përgjigje edhe nga ana e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve por nuk ka pranuar përgjigje.

MD, po ashtu ka thënë se nga hyrja në fuqi e LKVK-së e deri tash, në buxhetin e Programit nuk ka arritur asnjë donacion vullnetar.

Çështja e buxhetit të Programit është e rregulluar edhe me paragrafin 5 të nenit 39, të LKVK-së, sipas të cilit parashihet që *“Niveli i ndarjeve buxhetore për programin e kompensimit të viktimave të krimit do të bëhet përmes proceseve të rregullta buxhetore, duke marrë parasysh të hyrat e pritura nga paragrafi 3 i këtij Neni, të hyrat nga shitja e pasurisë së paligjshme të konfiskuar, të hyrat nga dorëzania e konfiskuar në pajtim me ligjin si dhe nivelin e përgjithshëm të të hyrave të pritura buxhetore dhe kërkesave për financim nga Buxheti i Kosovës”*, mirëpo në bazë të këtyre gjetjeve, po ashtu mund të konkludohet se buxheti i Programit për kompensimin e viktimave të krimit, është duke u financuar vetëm nga ana e taksave të shqiptuara nga gjykatat e vendit, pasi të njëjtat janë duke siguruar më shumë të hyra sesa buxheti i Programit, ndërsa Qeveria e Kosovës duket se nuk është duke kontribuar fare për ta rritur këtë buxhet.

⁴⁸ Shënim: 87,000.00 në vitin 2018, 78,000.00 në vitin 2019, dhe 78,000.00 në vitin 2020.

⁴⁹ Përgjigja e MD-së për IKD-në. 08.10.2021.



Grafiku 8. Dallimi në mes të hyrave të KGJK-së/KPK-së dhe Buxhetit të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

7.3. Të hyrat nga taksat për kompensimin e viktimave të krimit sipas gjykatave

Në bazë të analizës së të hyrave që gjykatat i sigurojnë Programit të Kompensimit të Viktimave të Krimit, rezulton se mjetet më të mëdha, me gjithë problemet me zbatimin e LKVK-së nga të gjithë gjyqtarët, për shkak të numrit më të madh të lëndëve, sigurohen nga Gjykatat Themelore në Prishtinë. Kjo gjykatë nga janari i vitit 2020 e deri në qershor të vitit 2021, ka detyruar të pandehurit të cilët i ka dënuar të paguajnë taksën për viktimat e krimit, në vlerë prej 57,130.00 euro. Ashtu siç është vërtetuar edhe nga analizimi i aktgjykimeve, Gjykata Themelore në Prizren është një nga gjykatat që zbatojnë më së miri LKVK-në, çka ka

ndikuar që nga kjo gjykatë, në kodin buxhetor të KGJK-së për viktimat e krimit, gjatë kësaj periudhe raportuese të arrijnë 48,820 euro.

38,980 euro janë grumbulluar nga Gjykata Themelore në Gjakovë, 36,380.00 të tjera nga ajo në Pejë dhe 28,270 nga ajo në Ferizaj. Grumbullim më të ulët nga këto taksa janë siguruar nga Gjykata Themelore në Gjiilan, me 22,970 euro dhe ajo në Mitrovicë me 14,280 euro. Në total, nga aktgjykimet dënuese të shtatë (7) gjykatave themelore, janë grumbulluar të hyra në vlerë prej 252,830 euro.

Gjykatat Themelore			2020	2021	Totali
Gjykata Prishtinë	Themelore	në	€ 31,670.00	€ 25,460.00	€ 57,130.00
Gjykata Prizren	Themelore	në	€ 31,250.00	€ 23,570.00	€ 54,820.00
Gjykata Gjakovë	Themelore	në	€ 23,130.00	€ 15,850.00	€ 38,980.00
Gjykata Themelore në Pejë			€ 21,620.00	€ 14,760.00	€ 36,380.00
Gjykata Ferizaj	Themelore	në	€ 15,880.00	€ 12,390.00	€ 28,270.00
Gjykata Gjilan	Themelore	në	€ 13,080.00	€ 9,890.00	€ 22,970.00
Gjykata Mitrovicë	Themelore	në	€ 8,900.00	€ 5,380.00	€ 14,280.00
Totali			€ 145,530.00	€ 107,300.00	€ 252,830.00

Tabela 4. Kërkesat e viktimave të krimit dhe vendimmarrja e Komisionit për gjatë viteve 2020 dhe 1 janar-30 qershor 2021.

7.4. Ndikimi i IKD-së në rritjen e buxhetit të Programit

Nga të dhënat e KGJK-së, të dërguara në tetor të vitit 2019, ishte parë që nga viti 2015 kur kishte hyrë ligji në fuqi e deri në shtator 2019, në emër të kompensimit për viktimat e krimit, ishin grumbulluar 111,670 euro. Pas intervistimit të krerëve të gjykatave dhe degëve të gjykatave, që ishin realizuar gjatë muajit tetor të vitit 2019, ishte parë që vetëm në muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të atij viti, kishte pasur ngritje të të hyrave nga taksat, kjo ngase përderisa në periudhën janar-shtator 2019, për një muaj janë grumbulluar mesatarisht 12,407 euro, në tre mujorin e fundit të atij viti, ishin mbledhur nga gjykatat 46,800.00 euro apo mesatarisht 15,600.00 euro në muaj.

Për qëllime të këtij hulumtimi, IKD ka analizuar edhe të hyrat e gjykatave edhe në

vitin 2020 dhe nga janari e deri në qershor të vitit 2021. Nga të dhënat e dërguara nga KGJK, rezulton se gjatë vitit 2020, pavarësisht situatës me pandeminë me Covid-19, ku për disa muaj nuk ka pasur zhvillim të proceseve gjyqësore, janë siguruar 145,530.00 euro, ndërsa nga fillimi i vitit e deri në qershor të vitit 2021, në KGJK kanë arritur 107,300.00 nga taksat për viktimat e krimit.⁵⁰ Pra në total, nga tetori i vitit 2019 e deri më 30 qershor 2021, nga shqiptimi i taksave për kompensimin e viktimave të krimit, janë arritur të sigurohen 299,630.00 euro.

Nga ky krahasim i të dhënave mund të nxirret përfundimi se nga hyrja në fuqi e LKVK-së në vitin 2015 e deri në shtator të vitit 2019, pra në një periudhë mbi pesë (5) vjeçare,

⁵⁰ Të dhënat e dërguara nga KGJK përmes postës elektronike. 19.10.2021.

gjyqtarët kishin detyruar të pandehurit e dënuar, që në emër të taksës të paguajnë shumën në vlerë prej 195,141.00 euro, ndërsa pas fillimit të hulumtimit të IKD-së lidhur me zbatimin e LKVK-së nga gjyqtarët, pas intervistave me Kryesuesin e KGJK-së, kryetarët e gjykatave, gjyqtarët mbikëqyrës të degëve të gjykatave, diskutimit me gjyqtarë në mënyrë individuale dhe

publikimit të raportit “Dështimi i gjykatave në mbushjen e programit për kompensimin e viktimave të krimit”, vetëm gjatë periudhës tetor 2019 e deri në qershor të vitit 2021, apo për një (1) vit e nëntë (9) muaj, ka ndikuar që nga gjykatat të sigurohen fonde për Program në vlerë prej 299,630.00 euro apo 104,489.00 euro më shumë se në periudhën paraprake.

Të hyra para Hulumtimit të IKD	Të hyra
2015	€ -
2016	€ -
2017	€ 1,620.00
2018	€ 81,851.00
Janar-Shtator 2019	€ 111,679.00
Totali	€ 195,150.00

Të hyra pas Hulumtimit të IKD	Të hyra
Tetor - Dhjetor 2019	€ 46,800.00
2020	€ 145,530.00
Janar-Qershor 2021	€ 107,300.00
Totali	€ 299,630.00

Tabela 4. Dallimi në mes të hyrave të KGJK-së para hulumtimit të parë të IKD-së lidhur me zbatimin e LKVK-së dhe pas hulumtimit.

10. Institucionet publike nuk informojnë viktimat e krimit për ekzistimin e LKVK

Përpos analizimit të financimit të buxhetit të Programit të Viktimave të Krimit, IKD ka analizuar në mënyrë të detajuar edhe zbatimin e paragrafit 1, të nenit 28 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Kjo dispozitë shumë e rëndësishme e këtij ligji përcakton obligimin e institucioneve publike për të dhënë informata për të drejtën e viktimave të krimit për kompensim nga shteti. Sa më i madh të jetë informimi i viktimave të krimit, aq më shumë ka gjasa që të rriten kërkesat e viktimave për kompensim.

Paragrafi 1 të neni 28 ka përcaktuar se: *“Secili institucion i cili bie në kontakt me viktimën, ka për obligim të informojë atë për të drejtën në kompensim sipas këtij ligji. Institucionet shëndetësore, sociale, policia, prokuroria dhe gjykatat duhet t’i vendosin këto informata në dispozicion në vende publike.”*⁵¹ Qëllimi i ligjdhënësit përmes kësaj dispozite, ka qenë që qytetarët të cilët potencialisht mund të jenë viktimat e krimit, të kenë qasje dhe informim sa më të lehtë për mundësinë e kompensimit, pikërisht në institucionet ku mund të jetë adresa e parë pas viktimizimit.

Lidhur me zbatimin e kërkesës ligjore për informimin e qytetarëve për mundësinë e kompensimit të viktimave të krimit, IKD

përmes ekipit të monitoruesve ka vizituar 182 institucione publike në 35 komuna të Kosovës.⁵² Në këtë monitorim janë përfshirë institucione si Gjykata, Prokurori, KGJK, KPK, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKSH), Ministria e Drejtësisë, Stacionet Policore, Komunitat, Spitalet-Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendrat për Punë Sociale (QPS) dhe Strehimoret.⁵³

Monitorimi i këtyre institucioneve është realizuar më 4-8 tetor 2021 ndërsa monitorimi i KGJK-së, KPK-së, ZKSH dhe PSRK-së për këto çështje, është zhvilluar më 20 tetor 2021.

Në këtë monitorim janë vizituar 36 stacione policore,⁵⁴ 35 QKMF, 34 objekte komunale,⁵⁵ 32 QPS, 27 gjykata, ku përfshihen Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit si dhe shtatë (7) gjykatat themelore dhe shumica nga degët e tyre, nëntë (9) zyre të Prokurorit të Shtetit, ku përpos shtatë (7) prokurorive themelore, përfshihen edhe Prokuroria e Apelit dhe Prokuroria Speciale, katër (4) strehimore si dhe objektet e KGJK-së, KPK-së, ZKP-së, Zyrës për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave si dhe Ministrinë e Drejtësisë.

⁵¹ Paragrafi 1, neni 28 i Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.


⁵² Për arsye teknike, monitorimi i institucioneve nuk ka mundur të realizohet në Komunitat Zveqan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

⁵³ *Shënim:* Pasi si vendet më të shpeshta ku qytetarët mund të paraqiten, janë edhe Komunitat, IKD në kuadër të këtij monitorimi ka vlerësuar të rëndësishëm edhe vizitat në Komuna, për të parë mos ndonjëra nga to ka

informata për viktimat e krimit, edhe pse sipas LPKV-së nuk përcaktohet në mënyrë të prerë. Njëjtë është vepruar edhe me MD-në.

⁵⁴ *Shënim:* Në Komunën e Prishtinës janë vizituar Stacioni Policor “Qendra”, ai të lagjia e Muhaxherve dhe Stacioni Policor në objektin e Ish-Hotelit “Victory”.

⁵⁵ *Sqarim:* Nga 35 komuna e vizituara, monitorim nuk i është bërë vetëm Komunës së Mitrovicës së Veriut.




Grafiku 9. Monitorimi i IKD-së në 182 institucione publike lidhur me (mos) informimin e publikut për ekzistimin e LKVK-së.

8.1. Vetëm 2.73% nga 182 institucionet publike kanë informata publike për Programin e Kompensimit të Viktimave të Krimit

Nga monitorimi që IKD i ka bërë 182 institucioneve publike, është gjetur se në vetëm pesë (5) institucione apo 2.73% ka informata për Programin e Viktimave të Krimit, të cilat mund të konsiderohen se kanë përmbushur obligimin ligjor që rrjedhë nga neni 28 i LKVK-së, ndërsa 178 institucione apo 97.81% nuk e kanë zbatuar obligimin


duke mos vendosur asnjë fletushkë informimi në tabelat informuese në hyrjet apo brenda objekteve të tyre. Mirëpo duhet shtuar se në katër (4) nga këto pesë (5) institucione në të cilat ka fletushka informuese, të njëjtat nuk janë të vendosur nga këto institucione por ata janë të përgatitura nga Ambasada Amerikane në Kosovë.



Grafiku 10. Monitorimi i IKD-së në 182 institucione publike lidhur me (mos) informimin e publikut për ekzistimin e LKVK-së.

IKD ka gjetur se viktimat potenciale të krimit do të mund të njoftohen përmes fletushkave informuese vetëm në një (1) gjykatë, një (1), një (1) prokurori, një (1) stacion policor dhe dy (2) QPS.

Nga 27 gjykata të monitoruara⁵⁶, është gjetur që vetëm Gjykata Themelore në Gjakovë në hyrje të saj ka informata për publikun lidhur me mundësinë që viktimat e krimit të kompensohen.



Fotografia 1. Të dhënat informuese për viktimat e krimit në Gjykatën Themelore në Gjakovë.

⁵⁶ Shënim: IKD ka kërkuar informata nga të gjitha gjykatat se pse nuk janë të vendosura informatat për viktimat e krimit dhe përgjigje ka kthyer vetëm Gjykata e Apelit, të cilët kanë thënë se nuk ka të vendosur momentalisht por që do ta vendosin shumë shpejtë dhe Gjykata Themelore në Ferizaj të cilët kanë thënë se nuk kanë qenë të vendosura por pas interesimit të IKD-së, ato tashmë janë vendosur.

Nga të gjitha prokuroritë⁵⁷, vetëm Prokuroria Themelore në Prizren ka njoftim për viktimat e krimit dhe që se ato mund të përfitojnë nga LKVK-ja.



Fotografia 2. Të dhënat informuese për viktimat e krimit në Prokurorinë Themelore në Prizren.


⁵⁷ Shënim: IKD ka kërkuar informata nga të gjitha prokuroritë se pse nuk janë të vendosura informatat për viktimat e krimit por përpos asaj në Gjakovë, prokuroritë tjera nuk kanë kthyer përgjigje. Prokuroria Themelore në Prishtinë, kanë thënë se këtë pyetje duhet adresuar te kordinatorja për rastet e dhunës në familje në kuadër të Prokurorit të Shtetit, znj. Sevdije Morina.

Ndërsa, nga 36 stacionet policore⁵⁸ që IKD ka vizituar, informata për viktimat e krimit ka pasur vetëm në Stacionin Policor në Ferizaj.



Fotografia 3. Të dhënat informuese për viktimat e krimit në Stacionin Policor në Ferizaj.

Kurse nga 32 QPS-të e vizituara, në dy (2) prej tyre ka pasur informata për viktimat e krimit dhe atë në QPS-në në Klinë dhe në atë të Komunës së Dragashit.



Fotografia 5. Të dhënat informuese për viktimat e krimit në QPS-në e Komunës së Dragashit.

Fotografia 4. Të dhënat informuese për viktimat e krimit në QPS-në e Komunës së Klinës.

⁵⁸ IKD ka kërkuar informata nga Policia e Kosovës se pse nuk janë të vendosura informatat për viktimat e krimit por që nuk kanë kthyer përgjigje.

Në QKMF-në e Komunës së Hanit të Elezit dhe në QKMF-në e Komunës së Vushtrrisë, ka pasur informata me numra kontaktues të ZMNV-së, kurse informata për të kontaktuar me një linjë, për viktimat e dhunës seksuale dhe me bazë gjinore, ka pasur edhe në Komunën e Gjilanit. Duhet shtuar po ashtu se pasi ishte kryer monitorimi në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec dhe në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, janë vendosur fletushkat informuese për Programin e Viktimave të Krimit.

Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës si institucione të rëndësishme për procesin e kompensimit të viktimave të krimit nuk e kanë zbatuar ligjin duke mos vendosur asnjë informatë për qytetarët në objektet e tyre e as nuk janë kujdesur nëse në Prokurori, konkretisht në Gjykatat e vendit, ka mungesë të informacioneve për viktimat e krimit. Ndërsa nga monitorimi i IKD-së, është parë se gjyqtarët asnjëherë nuk i informojnë viktimat e krimit se nëse ata nuk kërkojnë dëmshpërblim nga i pandehuri në procedurë penale, do të privohen nga e drejta që të kërkojnë kompensim sipas LKVK-së.

Shqetësuese është që mungesë të informatave publike ka pasur edhe në zyrën qendrore të Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit (ZMVK) e cila vepron e pavarur brenda zyrës së Prokurorit të Shtetit, e cila edhe ka shtatë (7) zyre regjionale të vendosura në Prokuroritë Themelore në Republikën e Kosovës. Përderisa kjo zyrë ka për qëllim institucionalizimin e të drejtave të viktimave të krimit, përfaqësimin, këshillimin dhe përkrahjen për të pasur qasje në sistemin e drejtësisë, konsiderojmë se e njëjta ka dështuar në aspektin e informimit të duhur të

viktimave dhe qytetarëve siç përcaktohet me dispozita ligjore. Në këtë linjë, ZMVK si organ i pavarur i cili merret ekskluzivisht vetëm me trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me viktimat e krimit duhet të zbatojë dhe të veprojë në harmoni të plotë me Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimit si bazë për krijimin e një programi efektiv për kompensimin e viktimave të krimit.

Fatkeqësisht edhe në institucionet e tjera publike si Ministria e Drejtësisë e cila ka rol shumë me rëndësi në zbatimin e LKVK-së, nuk është hasur në fletushka informuese në objektet e saj, e ngjashëm edhe në 34 Komunitat e Republikës së Kosovës të cilat do të duhej të ishin në shërbim të qytetarëve edhe sa i përket informimit në interes të tyre, por që është parë se ato nuk kanë të vendosur asnjë njoftim apo informatë relevante për viktimat e krimit në tabelat informuese të objekteve të tyre. Gjatë monitorimit të institucioneve në terren, është vërejtur se nga 36 Stacione Policore sa është numri i përgjithshëm në tërë Republikën e Kosovës, vetëm Stacioni Policor në Ferizaj e ka përmbushur obligimin i cili rrjedhë nga LKVK dhe duke ditur faktin se në shumicën e rasteve, viktimat pas veprës penale nga të cilat ato binë viktimë, dera e parë që e vizitojnë është ajo e Policisë së Kosovës, është e domosdoshme që ata të mund të informohen për ekzistencën e LKVK-së, ndërsa mos zbatimi i LKVK-së në këtë pikë pa dyshim se mund të konsiderohet i papranueshëm. Sa i përket katër (4) strehimoreve të vizituara, në objektet e tyre nuk kanë ofruar asnjë të dhënë apo njoftime për të drejtat e viktimave të krimit.

Ndërsa, Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) përpos në Han të Elezit, Prizren dhe Vushtrri, të cilat kanë vendosur numra kontaktues të ZMNV-në, mirëpo jo edhe ndonjë informatë tjetër për të drejtat e viktimave të krimit për kompensim, QKMF-të në komunat e tjera të Kosovës nuk kanë vendosur asnjë informatë lidhur me viktimat e krimit. Ndërkaq, nga 32 QPS në Republikën e Kosovës, përpos asaj në Dragash dhe Klinë, të cilat kanë vendosur informatat e nevojshme që përfshijnë të drejtat e viktimave të krimit për kompensim, në 30 QPS-të e komunave të tjera nuk ka pasur asnjë informatë të tillë. Në QKMF-në e Komunës së Hanit të Elezit dhe në QKMF-në e Komunës së Vushtrrisë, ka pasur informata me numra kontaktues të ZMNV-së, kurse informata për të kontaktuar me një linjë, për viktimat e dhunës seksuale dhe me bazë gjinore, ka pasur edhe në Komunën e Gjilanit.

Duhet shtuar po ashtu se pasi ishte kryer monitorimi në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec dhe në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, janë vendosur fletushkat informuese për Programin e Viktimave të Krimit. Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës si institucione të rëndësishme për procesin e kompensimit të viktimave të krimit nuk e kanë zbatuar ligjin duke mos vendosur asnjë informatë për qytetarët në objektet e tyre e as nuk janë kujdesur nëse në Prokurori, konkretisht në Gjykatat e vendit, ka mungesë të informacioneve për viktimat e krimit.

Ndërsa nga monitorimi i IKD-së, është parë se gjyqtarët asnjëherë nuk i informojnë viktimat e krimit se nëse ata nuk kërkojnë

dëmshpërblim nga i pandehuri në procedurë penale, do të privohen nga e drejta që të kërkojnë kompensim sipas LKVK-së. Shqetësuese është që mungesë të informatave publike ka pasur edhe në zyrën qendrore të Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit (ZMVK) e cila vepron e pavarur brenda zyrës së Prokurorit të Shtetit, e cila edhe ka shtatë (7) zyre regjionale të vendosura në Prokuroritë Themelore në Republikën e Kosovës. Përderisa kjo zyrë ka për qëllim institucionalizimin e të drejtave të viktimave të krimit, përfaqësimin, këshillimin dhe përkrahjen për të pasur qasje në sistemin e drejtësisë, konsiderojmë se e njëjta ka dështuar në aspektin e informimit të duhur të viktimave dhe qytetarëve siç përcaktohet me dispozita ligjore. Në këtë linjë, ZMVK si organ i pavarur i cili merret ekskluzivisht vetëm me trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me viktimat e krimit duhet të zbatojë dhe të veprojë në harmoni të plotë me Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimit si bazë për krijimin e një programi efektiv për kompensimin e viktimave të krimit.

Fatkeqësisht edhe në institucionet e tjera publike si Ministria e Drejtësisë e cila ka rol shumë me rëndësi në zbatimin e LKVK-së, nuk është hasur në fletushka informuese në objektet e saj, e ngjashëm edhe në 34 Komunat e Republikës së Kosovës të cilat do të duhej të ishin në shërbim të qytetarëve edhe sa i përket informimit në interes të tyre, por që është parë se ato nuk kanë të vendosur asnjë njoftim apo informatë relevante për viktimat e krimit në tabelat informuese të objekteve të tyre.

Gjatë monitorimit të institucioneve në terren, është vërejtur se nga 36 Stacione Policore sa

është numri i përgjithshëm në tërë Republikën e Kosovës, vetëm Stacioni Policor në Ferizaj e ka përmbushur obligimin i cili rrjedhë nga LKVK dhe duke ditur faktin se në shumicën e rasteve, viktimat pas veprës penale nga të cilat ato binë viktimë, dera e parë që e vizitojnë është ajo e Policisë së Kosovës, është e domosdoshme që ata të mund të informohen për ekzistencën e LKVK-së, ndërsa mos zbatimi i LKVK-së në këtë pikë pa dyshim se mund të konsiderohet i papranueshëm. Sa i përket katër (4) strehimoreve të vizituara, në objektet e tyre nuk kanë ofruar asnjë të dhënë apo njoftime për të drejtat e viktimave të krimit.

Ndërsa, Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) përpos në Han të Elezit, Prizren dhe Vushtrri, të cilat kanë vendosur numra kontaktues të ZMNV-në, mirëpo jo edhe ndonjë informatë tjetër për të drejtat e viktimave të krimit për kompensim, QKMF-të në komunat e tjera të Kosovës nuk kanë vendosur asnjë informatë lidhur me viktimat e krimit. Ndërkaq, nga 32 QPS në Republikën e Kosovës, përpos asaj në Dragash dhe Klinë, të cilat kanë vendosur informatat e nevojshme që përfshijnë të drejtat e viktimave të krimit për kompensim, në 30 QPS-të e komunave të tjera nuk ka pasur asnjë informatë të tillë.

11. Përfundimet

Përfundimet lidhur me Buxhetin e Programit dhe trajtimin e kërkesave nga Komisioni

- Gjatë periudhës kohore 2019 - qershor 2021, në Komision janë bërë 83 kërkesa për kompensim të viktimave të krimit, ndërsa gjatë kësaj periudhe janë trajtuar edhe katër (4) kërkesa që ishin bartur nga viti 2018. Nga 87 kërkesat e shqyrtuara nga ana e Komisionit, numri më i madh i tyre është bërë nga viktimat e veprave penale të vrasjeve dhe të dhunës në familje, ndërsa kërkesa në numër më të vogël janë bërë edhe për raste të veprave të tjera penale si trafikim me qenie njerëzore, ngacmim seksual, keqtrajtim seksual i fëmijëve, lëndime të rënda trupore dhe vepra të tjera penale.
- Nga 87 kërkesat e trajtuara në këtë periudhë raportuese, Komisioni ka aprovuar 34 kërkesa apo 39.08 %, ka refuzuar 43 të tjera apo 49.43%, ndërsa akoma nuk ka ndonjë vendim edhe për 10 raste të tjera apo 11.49%.
- Nga 34 kërkesat e aprovuara nga ana e Komisionit, viktimat e krimit janë kompensuar me një shumë të përgjithshme prej 144,395.13 euro.
- Me LKVK është paraparë që Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimit, mund të financohet në tri mënyra: a), nga buxheti i Republikës së Kosovës për MD-në si pjesë e ligjit vjetor të buxhetit, b) përmes kontributeve vullnetare dhe donacioneve private dhe c) nga taksat për kompensimin e viktimave të shqiptuara në aktgjykimet dënuese. Mirëpo, IKD ka gjetur se nga funksionalizimi i Programit, Qeveria i ka ndarë vetëm 187 mijë euro, për vitet 2017 dhe 2018, ndërsa pas kësaj periudhe buxheti i Programit është siguruar vetëm nga të hyrat e KGJK-së dhe KPK-së.
- Pas funksionalizimit të Programit, buxheti nuk ishte parë si problem i Komisionit për Kompensim të Viktimave të Krimit, por në atë kohë shqetësuese ishte që viktimat nuk kishin informata për ekzistimin e këtij Komisioni dhe mundësinë që ata të kompensohen nga shteti, mirëpo situata ka ndryshuar pas vitit 2019, pasi Programi nuk është duke pasur buxhet për të gjitha kërkesat e aprovuara të viktimave.
- MD, për vitet 2019, 2020 dhe 2021, ka kërkuar nga Ministria e Financave, që për Program të sigurojë një buxhet në vlerë prej 78 mijë euro për secilin vit apo 234 mijë euro në total.
- Në vitin 2020, me aprovimin e 22 kërkesave të viktimave, ishte shpenzuar i gjithë buxheti i paraparë për kompensimin e viktimave të krimit. Për më tepër, gjatë këtij viti, edhe pse Komisioni ka pasur në dispozicion vetëm 78 mijë euro buxhet, ata kanë tejkaluar atë buxhet, duke kompensuar viktimat në vlerë prej 91,953.13 euro, por që vendimet e aprovuara në fund të vitit 2020, në mungesë të buxhetit, ishin shtyrë për pagesë në vitin 2021. Buxheti në vlerë prej 78 mijë euro nuk do të jetë i mjaftueshëm as për viktimat të cilat bëjnë kërkesë për kompensim gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2021. Kjo ngase Komisioni deri më 30 qershor 2021 ka kompensuar viktimat në shumën prej 33,200.00 euro

apo 42.06%, ndërsa pa një vendim të Komisionit, kanë mbetur edhe 10 kërkesa dhe kur këtyre u shtohen edhe kërkesat e tjera që potencialisht mund të bëhen gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2021, mund të konkludohet se edhe në këtë vit, mund të ketë raste kur viktimat për të cilat janë aprovuar kërkesat për kompensim do të i duhet të presin deri në vitin tjetër që të kompensohen. Kjo do të ishte në kundërshtim me qëllimin për të cilën është funksionalizuar Programi, që viktimat në procedura më të shpejta të kompensohen për situatën në të cilat kanë rënë

- Pas kërkesave të MD-së, në Program nga buxheti i Republikës së Kosovës, për vitet 2018, 2019 dhe 2020 janë ndarë 243 mijë euro, mirëpo në këtë periudhë raportuese, vetëm nga KGJK dhe KPK, në emër të kompensimit të viktimave të krimit janë siguruar 457,287.00 euro. 385, 851.00 nga KGJK dhe 71,436.00 nga KPK, të cilat fatkeqësisht nuk janë përfshirë në buxhetin e Programit.
- Mungesa e buxhetit të Programit ka ndikuar që viktimat e kompensuara të krimit në vitin 2020, të presin që t'i marrin të hyrat e tyre në vitin 2021 e në situatë të ngjashme mund të vijjnë edhe viktimat e kompensuara në gjysmën e dytë të vitit 2021
- MD-ja nuk ka informacione se sa të hyra ka realizuar KGJK dhe KPK, në emër të viktimave të krimit, ndërsa MFPT nuk është përgjigjur se ku janë shpenzuar edhe 214,287 euro, të siguruara nga KGJK dhe KPK, me qëllim të kompensimit të viktimave të krimit, pasi këto mjete janë paguar për tu transferuar në këtë Program, por që në kundërshtim me nenin 39 të LKVK-së, kjo gjë nuk ka ndodhur
- Nga hyrja në fuqi e LKVK-së e deri tash, në buxhetin e Programit, nuk ka arritur asnjë donacion vullnetar.
- Nga hyrja në fuqi e LKVK-së në vitin 2015 e deri në shtator të vitit 2019, pra në një periudhë mbi pesë (5) vjeçare, gjyqtarët kishin detyruar të pandehurit e dënuar, që në emër të taksës, të paguajnë shumën në vlerë prej 195,141.00 euro, ndërsa pas fillimit të hulumtimit të parë të IKD-së në tetor të vitit 2019 lidhur me zbatimin e LKVK-së nga gjyqtarët, pas intervistave me Kryesuesin e KGJK-së, kryetarët e gjykatave, gjyqtarët mbikëqyrës të degëve, diskutimit me gjyqtarë në mënyrë individuale dhe publikimit të raportit “Dështimi i gjykatave në mbushjen e programit për kompensimin e viktimave të krimit”, vetëm gjatë periudhës tetor 2019 e deri në qershor të vitit 2021, apo për një (1) vit e nëntë (9) muaj, ka ndikuar që nga gjykatat, të sigurohen fonde për Program në vlerë prej 299,630.00 euro apo 104,489.00 euro më shumë se në periudhën paraprake.

Përfundimet lidhur me zbatimin e taksës për viktimat e krimit nga gjyqtarët

- Nga 1,071 aktgjykime dënuese, të cilat janë shqiptuar nga 113 gjyqtarë të gjykatave themelore gjatë vitit 2020 (537) dhe janar-qershor 2021 (534), IKD ka gjetur se LKVK-ja është zbatuar në 820 aktgjykime apo 76.56%, ndërsa nuk ka pasur zbatim të këtij ligji në 251 aktgjykime apo 23.44%. Gjetje e cila tregon se gjyqtarët janë akoma larg zbatimit të plotë të LKVK-së, edhe pse i njëjti ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2015.
- Përderisa në raportin e parë të IKD-së që ka përfshirë vitet 2018 dhe 2019, në DKR kishte pasur zbatim të LKVK-së vetëm në 40% të aktgjykimeve, pas zhvillimit të intervistave me krerët e gjykatave nga IKD në vitin 2019, është parë se në DKR gjatë vitit 2020 dhe deri në qershor të viti 2021, zbatimi i këtij ligji ka pasur progres të shtuar, pasi është gjetur në 90% të aktgjykimeve të analizuara. Mirëpo situatë e ngjashme nuk është edhe për DP-në, pasi progresi i zbatimit në këtë departament është më i ulët. Në raportin e parë, IKD kishte gjetur zbatim të ligjit nga DP-të në 60% të aktgjykimeve, ndërsa për vitin 2020 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, në këtë departament ligji është zbatuar në 70.46% të aktgjykimeve të analizuara.
- Gjykata Themelore në Pejë, ajo në Ferizaj, Gjakovë dhe Gjykata Themelore në Prizren janë gjykatat të cilat kanë zbatuar më së shumti LKVK-në, ndërsa zbatim më i ulët të këtij ligji është gjetur në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Prishtinë dhe Gjiilan. Nga kjo analizë është parë se ka gjykata në të cilat ka një zbatim të plotë (100%) në DKR, ndërsa ka një zbatim më të ulët në DP, ku përfshihen edhe degët e këtyre gjykatave.
- IKD në vazhdimësi ka bërë thirrje që të ketë një zbatim të plotë të LKVK-së nga të gjithë gjyqtarët e të gjitha gjykatave, por pavarësisht kësaj zbatimin e këtij ligji, për shkak të mangësisë ligjore, nuk mund të bëhet edhe për gjyqtarët e Departamentit Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë. Ky Departament, ishte funksionalizuar për herë të parë me Ligjin nr 06/L-054 për Gjykatat, kishte hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2018, ndërsa Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ka hyrë në fuqi më 15 korrik 2015 dhe paragrafi 3 i nenit 39 të këtij ligji ka përcaktuar që taksa për viktimat e krimit të përcaktohet vetëm në aktgjykimet dënuese të Departamentit të Krimeve të Rënda dhe në ato të Departamentit të Përgjithshëm dhe nga ajo kohë nuk është miratuar në Kuvendin e Kosovës ndonjë ndryshim-plotësim të këtij ligji. Nga 25 aktgjykime të analizuara të DS-së, është gjetur se gjyqtarët pas asnjë bazë ligjore, kanë detyruar të pandehurit e dënuar të paguajnë taksën për viktimat e krimit në tetë (8) raste, kurse nuk kanë zbatuar këtë ligj në 12 raste
- Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, është e vetmja gjykatë e cila ka mundësi që pas ankesave të prokurorisë mbrojtjes apo të dëmtuarave, të bëjë vlerësimet e aktgjykimeve nga të gjitha gjykatat themelore të Kosovës dhe në këtë mënyrë ta unifikoj praktikën e të gjitha gjykatave themelore. Mirëpo në raport me zbatimin e plotë të LKVK-së, nga dy

hulumtimet e IKD-së, rezulton se nuk është duke e luajtur, ngase nuk është gjetur asnjë aktgjykim i Gjykatës së Apelit i cili ka zbatuar LKVK-në edhe në rastet kur këtë nuk e kanë bërë gjykatat e shkallës së parë. IKD ka siguruar 38 aktgjykime në të cilat shkalla e parë nuk i kishte detyruar të dënuarit të paguanin taksën për viktimat e krimit, por që Apeli në këto vendime me të cilat ka vërtetuar aktgjykimet e shkallës së parë apo ka ndryshuar ato, në asnjë (0) rast, nuk e ka zbatuar LKVK-në

- Përpos IKD-së, mos zbatimin e LKVK-së e ka konsideruar si shkelje edhe Ish-Kryetari i Gjykatës së Apelit Hasan Shala, ai në intervistën për IKD-në lidhur me gjetjet e raportit të parë, që ishte realizuar në tetor të vitit 2019, kishte thënë se gjyqtarët e gjykatës së Apelit në rastin kur të vendosin meritorisht për vendimet e shkallës së parë, në rastin kur kjo taksë nuk është caktuar, atëherë taksën do ta caktojnë vetë ata pasi mos zbatimi i LKVK – së konsiderohet shkelje, mirëpo pavarësisht kësaj mos zbatimi i ligjit është parë edhe në aktgjykimet e vitit 2020 dhe 2021
- Me gjithë faktin se gati të gjithë kryetarët e gjykatave në intervistat e tyre, mos zbatimin e LKVK-së e kishin konsideruar shkelje ligjore, deri më tani në KGJK nuk ka asnjë iniciativë disiplinore për gjyqtarët të cilët nuk e kanë zbatuar LKVK-në

Përfundimet lidhur me informimin e viktimave të krimit nga institucionet publike

- IKD përmes ekipit të monitoruesve, ka vizituar 182 institucione publike në 35 komuna të Kosovës, në të cilat janë përfshirë 36 stacione policore 35 QKMF, 34 objekte komunale, 32 QPS, 27 gjykata, ku përfshihen Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit si dhe shtatë (7) gjykatat themelore dhe shumica nga degët e tyre, nëntë (9) zyre të Prokurorit të Shtetit, ku përpos shtatë (7) prokurorive themelore, përfshihen edhe Prokuroria e Apelit dhe Prokuroria Speciale, katër (4) strehimore si dhe objektet e KGJK-së, KPK-së, ZKP-së, Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave si dhe Ministrinë e Drejtësisë dhe ka gjetur se vetëm në pesë (5) prej tyre apo vetëm në 2.73% të institucioneve publike viktimat e krimit mund të njoftohen për mundësinë e kompensimit
- Gjykata Themelore në Gjakovë, Prokuroria Themelore në Prizren, Stacioni Policor në Ferizaj, Qendra për Punës Sociale e Komunës së Dragashit dhe Qendra për Punës Sociale e Komunës së Klinës, janë të vetmet institucione të cilat kanë pasur informata në objektet e tyre për mundësinë e kompensimit. Përpos Prokurorisë Themelore në Prizren, në katër (4) institucionet tjera në të cilat ka fletushka informuese, të njëjtat nuk janë të vendosur nga këto institucione por janë të përgatitura nga Ambasada Amerikane në Kosovë
- Prokuroria Themelore në Prizren, QKMF-ja e Komunës së Hanit të Elezit dhe QKMF-ja e Komunës së Vushtrrisë, ka pasur informata me numra kontaktues të ZMNV-së, kurse informata për të kontaktuar me një linjë, për viktimat e dhunës seksuale dhe me bazë gjinore, ka pasur edhe në Komunën e Gjilanit

- Disa ditë pasi IKD kishte kryer monitorimin në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec dhe në Prokurorin Themelore në Gjakovë edhe në këto institucione janë vendosur fletushkat informuese për Programin e Viktimave të Krimet, si donacion nga Ambasada Amerikane.
- Nga monitorimi i IKD-së, është parë se gjyqtarët asnjëherë nuk i informojnë viktimat e krimet se nëse ata nuk kërkojnë dëmshpërblim nga i pandehuri në procedurë penale, do të privohen nga e drejta që të kërkojnë kompensim sipas LKVK-së.

12. Rekomandimet

Për Ministrinë e Drejtësisë

1. Ministria e Drejtësisë në baza të rregullta, të kërkojë informacione nga MFPT lidhur me të hyrat e grumbulluara nga taksat për viktimat e krimit, të shqiptuara nga gjykatat
2. Ministria e Drejtësisë në baza të rregullta, të kërkojë informacione nga MFPT lidhur me të hyrat e grumbulluara nga KPK-ja.
3. Ministria e Drejtësisë, për çdo vit të kërkojë nga MFPT që të gjitha të hyrat e grumbulluara nga KGJK dhe KPK për kompensimin e viktimave të krimit, të transferohen në buxhetin e Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit
4. Duke marrë parasysh rritjen e numrit të kërkesave të viktimave dhe në mënyrë që viktimat për të cilat është aprovuar kërkesa për kompensim të mos presin me muaj, Ministria e Drejtësisë, përveç të hyrave të siguruara nga KGJK dhe KPK, të kërkojë që edhe Qeveria të ndaj mjete financiare për Programin.

Për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

1. MFPT-ja, ndarjen buxhetore për Programin ta bëjë ashtu siç kërkohet me paragrafin 5 të nenit 39 të LKV-së, e jo të hyrat e siguruara nga gjykatat për Programin, t'i alokoj për qëllime të tjera

2. MFPT-ja të rris transparencën në kërkesat për informata lidhur me të hyrat e grumbulluara nga KGJK dhe KPK, në emër të kompensimit të viktimave të krimit

Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

1. KGJK-ja sa më parë, në kuadër të një mbledhje të saj, ta trajtojë zbatimin e LKVK-së në një pikë të veçantë të rendit të ditës
2. KGJK-ja duhet të identifikojë rastet e moszbatimit të LKVK-së dhe duhet të ndërmerre veprime të shpejta në mënyrë që të rriten të hyrat për buxhetin që duhet të arkëtohen për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit
3. KGJK duhet që të krijojë databazë në të cilën do të evidentohet numri i personave të dënuar me vendim të formës së prerë për secilën gjykatë dhe departament, në mënyrë që të analizohet raporti në mes aktgjykimeve dënuese dhe të hyrave që grumbullohen nga shqiptimi i taksës siç përcaktohet me LKVK-në

Për Gjykatën Supreme

1. Gjykata Supreme të nxjerr një mendim juridik se a duhet zbatuar LKVK-ja në rastet kur i pandehuri shpallet fajtor dhe lirohet nga të gjitha shpenzimet e procedurës penale.

Për Gjykatën e Apelit

1. Kryetari i Gjykatës së Apelit të organizojë takime me gjyqtarët e DKR-së dhe DP-së, në mënyrë që të vendoset që në rastet kur Apeli të vendos në mënyrë meritore për aktgjykimet dënuese, të përfshihet edhe taksa për viktimat e krimit
2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit duhet që në rastet e aktgjykimeve dënuese ta konsiderojnë si shkelje ligjore mungesën e obligimit të pagesës së taksës për kompensimin e viktimave të krimit dhe në rastin kur nuk ka arsye të kthimit në rigjykim, të njëjtat të ndryshohen, në mënyrë që të shqiptohet edhe taksa siç parashihet me LKVK-në

Për Gjykatat Themelore

1. Kryetaret e Gjykatave Themelore, të organizojnë takime me gjyqtarët e DKR-së dhe DP-së, në mënyrë që të vendoset që në të gjitha aktgjykimet dënuese, të përfshihet edhe taksa për viktimat e krimit
2. Gjyqtarët e të dy departamenteve duhet ta trajtojnë me seriozitet zbatimin e LKVK – së në të gjitha aktgjykimet dënuese e jo në disa raste të zbatojnë LKVK-në e në disa raste të mos e shqiptojnë taksën për viktimat e krimit.

3. Gjyqtarët të kenë kujdes që të zbatojnë me përpikëri rolin e tyre dhe në çdo rast t'i udhëzojnë viktimat lidhur me të drejtat e tyre ligjore, pra që të njoftohen lidhur me të drejtën e tyre për kompensim dhe t'i paralajmërojnë se nëse heqin dorë nga kërkesa pasurore juridike në procedurë penale, nuk do t'i mundësohet e drejta për kompensim nga Programi.
4. Gjyqtarët e Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të mos i obligojnë të pandehurit e dënuar që ta paguajnë taksën për kompensimin e viktimave të krimit, deri në hyrjen në fuqi të ndryshim/plotësimit të LKVK-së
5. Kryetarët e gjykatave si autoritete kompetente, të iniciojnë procedura disiplinore për të gjithë gjyqtarët të cilët nuk zbatojnë LKVK-në

Për institucionet publike (institucionet shëndetësore, sociale, policia, prokuroria dhe gjykatat)

1. Të gjitha institucionet shëndetësore, sociale, Policia, Prokuroria, gjykatat, komunat, MD-ja dhe institucionet e tjera të cilat kanë kontakt me viktimat e krimit, menjëherë të vendosin në objektet e tyre informata për mundësinë e kompensimit të viktimave të krimit.